

ALTIN TORBA



DOMOSDOSHMERIA E


Hixhabit

NË DRITËN E ARGUMENTEVE
HYJNORE DHE LOGJIKE

ALTIN TORBA

**DOMOSDOSHMERIA
E HIXHABIT NË DRITËN
E ARGUMENTEVE
HYJNORE DHE LOGJIKE**

HIXHABI ËSHTË LIGJ HYJNOR NË ISLAM,
HEBRAIZËM DHE KRISHTERIM



Titulli i librit:
DOMOSDOSHMERIA E HIXHABIT NË DRITËN
E ARGUMENTEVE HYJNORE DHE LOGJIKE

Hixhabi është ligj hyjnor në Islam,
Hebraizëm dhe Krishterim

ضرورة الحجاب في ضوء الأدلة الإلهية والعقلية
(الحجاب شرعية الله في الإسلام واليهودية والنصرانية)

Autori: Altin Torba
Facebook: Jeta e Vërtetë – Pyetje-Përgjigje Fetare Islame
Website: www.jetaever8.de (Jeta e Vërtetë)

Recensent fetar: Dr. Ahmed Kalaja
Redaktor gjuhësor: Eglantin Kurti
Faqosja: Erzen Pashaj
Kopertina: Fatlum Zeka

Botimi i parë: Shtator 2022
Mundësoi botimin: Esmerald Hushi

© Çdo publikim i plotë ose i pjesshëm i këtij libri është
i lejuar vetëm për qëllime jofitimprurëse. 2022

Publikimi i parë: Mars 2016

Ju ftojme ta shpërndani këtë punim, me qëllim që dobia
e tij të përhapet dhe së bashku të marrim shpërblimin
e publikuesit të fjalës së mirë.



*“Mos i zbuloni stolitë
(hijeshitë) tuaja,
ashtu siç zbuloheshin
në kohën e padijes
(periudhës paraislame).!”*

(Kuran, El-Ahzab: 33)




Dedikim

Ky libër i dedikohet çdo motre të dëlirë
muslimane në këtë botë...

Krijuesi i Lartmadhëruar bollëk në besim
ju dhashtë...

Qofshi faqebardha dhe të lumtura në këtë
dhe tjetrën jetë...

Allahu i Madhëruar ju begatofte me
Xhenetin Firdeus...



Dr. Katherine Bullock e sqaron qartë ndryshimin thelbësor mes gjykimit mbi hixhabin (mbulesën fetare të gruas) - të nxitur nga lavazhi mediatik perëndimor i trurit - dhe gjykimit të bazuar në përjetimin e vlerës hyjnore të veshjes së hixhabit. Ajo thotë:

“Në vitin 1991 pashë një kronikë lajmesh televizive, ku shfaqeshin gra turke që i ktheheshin veshjes së hixhabit. U shokova dhe ndjeva keqardhje për to. Thashë me vete: ‘Të gjorat ato, u është bërë lavazh (shpërlarje) truri nga kultura e tyre e mëparshme’. Isha e bindur - si shumë evropianë të tjerë -, se Islami i persekuton gratë, ndërsa hixhabi është simboli i persekutimit të tyre.

Imagjinojeni befasinë që më ndodhi pas katër vitesh, teksa e shihja veten para pasqyrës së një qendre tregtare, veshur me një rrobë që përfaqësonte tërësisht veshjen e atyre ‘grave të persekutuar’. E nisa udhëtimin tim shpirtëror në periudhën e magistraturës dhe pas katër vitesh pranova Islamin.

Ky udhëtim përfshi në etapat e tij transformimin tim nga urrejtja ndaj fesë islame, në respektimin e Islamit dhe interesimin për të deri në pranimin e tij”.

(Katherine Bullock, op. cit., p.xiii).

Tryeza e lëndës

Parathënie	13
------------	----

 REALITETI I PARË: Hixhabi në qytetërimet e hershme dhe ligjet hyjnore	21
--	----

SË PARI: Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave të qytetërimeve të hershme	23
---	----

SË DYTË: Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave ligjore hyjnore të Hebraizmit, Krishterimit dhe Islamit	26
--	----

FAKTI I PARË: Hixhabi në shoqërinë hebraike	26
--	----

FAKTI I DYTË: Hixhabi në shoqërinë e krishterë	32
---	----

SË TRETI: Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave ligjore hyjnore islame	41
--	----

FAKTI I PARË: Dispozita e hixhabit në Islam	41
--	----

FAKTI I DYTË: Domosdoshmëria e hixhabit pasqyruar në urtësitë Hyjnore islame të obligimit të tij	49
---	----

SË KATËRTI: Profeti (Paqja qoftë mbi të) model në sjelljen me femrat, mbi të cilin zbriti dispozita e obligimit të hixhabit	53
--	----

FAKTI I PARË: Modeli profetik legjitimon botën ideale, ku një grua mund të jetojë e çliruar dhe e dëlirë	53
FAKTI I DYTË: Kriteri profetik “Mirësia e individit varet nga mirësjellja e tij me bashkëshorten”	55
FAKTI I TRETË: Kriteri profetik “Gratë meritojnë barazi dhe kurrsesi antipati”	57
FAKTI I KATËRT: Dimensioni profetik i shpalosur në qëndrimet e tij (Paqja qoftë mbi të) ndaj femrës	58



REALITETI I DYTË: Domosdoshmëria e hixhabit në logjikën e shëndoshë

SË PARI: Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave të natyrës fiziologjike humane 64

FAKTI I PARË: Islami e njeh tërheqjen fiziologjike mes dy gjinive të kundërta njerëzore 64

FAKTI I DYTË: Epshi njerëzor është asnjans dhe si i tillë ai duhet kanalizuar 66

FAKTI I TRETË: Një epsh i pakontrolluar çon në rrënimin e lumturisë 67

FAKTI I KATËRT: Bota sensuale/sekssuale dhe roli i saj i patjetërsueshëm ndërmjet dy gjinive të kundërta 68

SË DYTË: Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave të mirëqenies sociale 70

FAKTI I PARË: Zhveshja nga hixhabi çon në zbërthim të familjes dhe mirëqenies sociale 70

FAKTI I DYTË: Zhveshja shpie në anarki, shtazëri dhe
zvetënim e kurrresi në qytetërim 71

FAKTI I TRETË: Hixhabi konsolidon etikën e lartë
dhe modestinë 73

FAKTI I KATËRT: Zhveshja graduale e femrës është
antonim i mirëqenies sociale të saj dhe të shoqërisë
ku ajo jeton 75

SË TRETË: Domosdoshmëria e hixhabit është
brenda kornizave të logjikës së shëndoshë 78

FAKTI I PARË: Zhveshja nga hixhabi është zhvlerësim 78

FAKTI I DYTË: Spekulumet me hixhabin bëhen për
interesa të ngushta nga njerëz joparimorë 79

FAKTI I TRETË: Hixhabi është traditë e grave të fisme
dhe mbron privatësinë e gruas 81

 **REALITETI I TRETË: Aspekte të spikatura juridike islame
mbi hixhabin** 83

SË PARI: Norma të hixhabit 84

SË DYTË: Thyerja e barrierave të veshjes së hixhabit 94

SË TRETË: Dy pyetje të shpeshta në lidhje me hixhabin 97

Referencat: 99

Prezantim i shkurtër me autorin: 103

Parathënie

Muslimani dhe muslimanja janë të obliguar, që të jetojnë sipas urdhrave të Allahut të Madhëruar dhe të Dërguarit të Tij (Paqja qoftë mbi të), sado të vështira dhe të rënda qofshin ato për unin (egon), pa u vënë aspak në siklet dhe pa ndjerë aspak ndrojtje prej njerëzve. Besimtari i vërtetë me besim të sinqertë, e kryen me çiltërsi dhe pastërti urdhrin e Zotit të tij të Lartmadhëruar dhe i përmbush me krenari urdhërimet dhe ndalesat e Tij. Nuk është aspak e denjë për besimtarin dhe besimtaren, që të frenohen a luhaten në çështjen e fesë, pasi është pjesë e përkushtimit, që dëgjimi dhe bindja të jenë të menjëhershme, bazuar në fjalën e Allahut të Madhëruar:

“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë, që kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren (diçka tjetër). Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”¹

Pozicionimi i përmendur në ajetin e mësipërm kuranor, ka qenë udha e besimtarëve të vërtetë, të cilët Allahu i ka lavdëruar në fjalët e Tij:

¹ - El-Ahzab: 36.

“Ndërsa përgjigjja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, është: ‘Dëgjojmë dhe bindemi’. Pikërisht këta janë të shpëtuarit. Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë.”²

Muslimani apo muslimanja që ka një zemër të gjallëruar me besim, është kurdohërë i gatshëm, që të heqë dorë nga çdo vepër, veprimi i të cilës e ekspozon ndaj ndëshkimit të Zotit të Lartmadhëruar, sepse besimtari i vërtetë është i bindur, se ndëshkimi i Zotit është i rreptë e i dhimbshëm dhe se zjarri i Tij është përcëllues, siç ka thënë Allahu i Madhëruar: **“Në të vërtetë, ai [që bën mëkate të mëdha, në këtë rast ai që përgojon tjetrin për ta dëmtuar] do të hidhet në torturën shkatërruese. E kush mund të ta shpjegojë ty, se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut.”³**

Nga ana tjetër, për gruan që i bindet Zotit të saj në urdhrat madhorë që Ai ia ka urdhëruar - siç është edhe urdhri për hixhabin, që do të trajtohet në këtë libër - shpresohet fitorja e hyrja në Xhenet, si dhe shpëtimi prej ndëshkimit në zjarrin e Xhehenemit; sepse ajo është në adhurim gjatë gjithë kohës që qëndron me hixhab, pasi po zbaton urdhrin e Zotit të saj dhe shpreson të fitojë shpërblimin e Tij...

Shpotitjet, lëndimet, fyerjet dhe presionet që i vijnë personit për shkak të përkushtimit të tij të saktë fetar, janë gjëra të pritshme dhe evitimi i tyre është në kundërshtim me rregullin; fyerjet, me të cilat ballafaqohet besimtarja me hixhab (veshja fetare e gruas), janë

² - En-Nur: 51-52.

³ - El-Humeze: 4-7.

pjesë e jetës së saj dhe duhen pranuar si realitet i pashmangshëm, duke i llogaritur ato si përpjekje për të fituar shpërblim nga Allahu i Madhëruar. Ky është detyrimi i besimit dhe çmimi i Xhenetit.

Nëse do të zmbrespsemi nga përkushtimi ynë fetar, sa herë që dikush na fyen, shumë shpejt do t'i braktisim simbolet parimore manifestuese të fesë sonë dhe pikërisht ky është përfundimi ku duan të na çojnë armiqtë tanë, të cilët kanë si qëllim të zhdukjin dhe të shuajnë shenjat përvijuese të së vërtetës nga sytë e njerëzve. Zhveshja nga simbolet manifestuese të fesë islame, sjell pasoja vërtet kritike, prandaj duhet bërë shumë kujdes në këtë pikë, pasi nga këtu fillon rrokullisja në greminën e e shejtanit...

Është vërtet për t'u çuditur me atë grua muslimane me virtyte të lavdërueshme, e cila falet dhe agjëron rregullisht, nuk hap sytë pas burrave të botës, shmang përgojimet e llafet dëmtuese poshtë e përpjetë, por megjithatë nuk arrin të vendosë, që ta veshë hixhabin; sepse në fakt angazhimi i çiltër me veprat e mira të lartpërmendura është tregues i madh i dashurisë së kësaj gruaje për të mirën dhe i distancimit të saj nga e keqja. Nuk duhet harruar gjithashtu, se namazi ndalon nga paturpësia, mëkati dhe të ndaluarat, se e mira tërheq (sjell) të mirën dhe se atë që i frikësohet Zotit të tij nga thellësia e vetes së tij, Allahu i Madhëruar do ta përkrahë dhe ndihmojë, që të disiplinojë egon e vet.

Me sa duket, një grua e tillë muslimane bart brenda vetes shumë mirësi dhe është në rrugën drejt përkushtimit tërësor, por për të arritur tek ky i fundit ajo duhet t'i kushtojë kujdes maksimal çështjes së hixhabit, të urdhëruar nga Allahu i Lartmadhëruar, duke u larguar nga dilemat dhe mëdyshjet. Ajo duhet t'i mposhtë presionet, që i vijnë nga njerëzit jofetarë e të mos iu dorëzohet shpotitjeve të tyre, duhet të braktisë përngjasimin me mëkatarët dhe modelet, që pispilloren në emër të modës, duhet t'i bëjë rezistencë epshit

të egos - që e fton të ekspozohet dhe të mburret me hijeshitë e saj femërore edhe aty ku s'duhet.

Femra muslimane duhet t'i përmbahet udhëzimeve fortifikuese dhe imunizuese hyjnore, të mos bjerë në cekëtirën e shndërrimit në mall kënaqjeje për njerëzit e paudhë që bredhin lart e poshtë, të refuzojë të bëhet arsye belaje a ngatërrese për robërit e Zotit dhe të durojë lëndimet a talljet që mund t'i bëhen, duke sjellë ndërmend shpërblimin madhështor që ka përgatitur Allahu i Lartmadhëruar për atë që kapet fort pas fesë islame në kohë të vështira. Në lidhje me këtë transmetohet, se Muhamedi (Paqja qoftë mbi të) u ka thënë shokëve të tij: *“Faktikisht pas jush do të vijë ditë (kohë), në të cilat sabri (të bësh durim) është si të kapësh prushin me dorë. Kush vepron (punë të mira) në ato ditë, merr shpërblimin e pesëdhjetë personave që kryejnë vepra si ato tua jat.”*⁴; pra bëhet fjalë për kohën e sprovave (që sipas të gjitha gjasave po e jetojmë sot), në të cilën muslimanët ballafaqohen nga të katër anët dhe në çdo kohë me dyndjen e të paudhëve të devijuar, të cilët joshin, manipulojnë dhe bëjnë propagandë për braktisjen tërësore a të pjesshme të parimeve dhe ritualeve hyjnore; dhe ky është shpërblimi madhështor për personin që kapet fuqishëm tek

⁴ - Ebu Daudi (4341), Et-Tirmidhi (3058), Ibn Maxhe (4014) dhe Ibn Hibani (385). Të gjithë zinxhirët e transmetimit të hadithit kanë dobësi, por disa dijetarë mendojnë, se hadithi është hasen (i besueshëm) për shkak të numrit të madh të zinxhirëve të transmetimit të hadithit dhe dëshmimeve të tij. Albani e vlerëson hadithin sahih (të vërtetë) në 'Silsiletu Es-Sahihah' (494), për shkak të zinxhirëve të shumtë të transmetimit.

feja islame në këtë kohë, person që pa dyshim posedon një durim të çeliktë, njëri skaj i të cilit është i lidhur fort me shpërblimin hyjnor madhështor të premtuar dhe skaji tjetër me zemrën e fuqishme besimtare. Ky durim i jep imunitet besimtarit, që të mos hedhë sytë poshtë e përpjetë dhe për më tepër të mos lakmojë haramet (ndalesat hyjnore), por e furnizon parreshtur me bindje ndaj Allahut dhe vetëpërmbajtje nga mëkatimi, si dhe e nxjerr triumfues ndaj gjithë kësaj belaje ...

Për besimtaren muslimane që ende nuk e ka zbatuar obligimin hyjnor të veshjes së hixhabit (mbulesës fetare të femrës), le të shërbejë si etalon prononcimi i Yvonne Ridley, gazetares së shquar angleze, që ka pranuar Islamin, e cila ka thënë:

“Nderimi në Islam arrihet përmes devotshmërisë (përkushtimit fetar) dhe jo nëpërmjet bukurisë, pasurisë, fuqisë, pozitës apo gjinisë. Pa më thuaj tani, më çliruese është që gjykimi mbi ty (si femër) të bëhet, duke u bazuar në gjatësinë e fundit tënd dhe madhësinë e gjoksit tënd të zmadhuar kozmetikisht; apo që gjykimi mbi ty të bëhet bazuar në personalitetin, mendjen dhe inteligjencën tënde?! Revistat e lustruara na thonë ne grave, se nëse s’jemi të gjata, elegante dhe të bukura, nuk do të na dashurojë dhe honepsë kush.”⁵

Bindja nëse një gjë është domosdoshmëri ose jo, duhet të jetë brenda kufijve apo kornizave të Sheriatit (ligjit hyjnor islam) dhe logjikës së shëndoshë, duke ditur se nuk ka ndodhur asnjëherë, që logjika të përplasët me Sheriatin islam...

Nuk ka kurrfarë dyshimi mbi faktin, se hixhabi (mbulesa fetare e gruas) është brenda kornizave të ligjit hyjnor dhe të logjikës së shëndoshë ...

⁵ - <http://yvonneridley.org/analysis-and-opinion/how-i-came-to-love-the-veil>.

Pikërisht për të vërtetuar domosdoshmërinë e hixhabit (mbulesës fetare të gruas) përmes realiteteve dhe fakteve normative hyjnore dhe logjike, si dhe për të argumentuar se hixhabi përbën një normativë juridike hyjnore jo vetëm në Islam, por edhe në Hebraizëm, në Krishterim dhe në qytetërimet e hershme, kemi përpiluar këtë libër, që shpresojmë të plotësojë sadopak zbrazëtinë në literaturën fetare shqipe, që trajton këtë subjekt.

Përmbajtja e librit

Realiteti i parë: Hixhabi në qytetërimet e hershme dhe ligjet hyjnore
Domosdoshmëria e hixhabit në qytetërimet e hershme
Zhveshja e femrës, risi e rendit të dekadave të fundit
Domosdoshmëria e hixhabit në Hebraizëm, Krishterim dhe Islam
Profeti (Paqja qoftë mbi të) model në sjelljen me femrat
Realiteti i dytë: Domosdoshmëria e hixhabit në logjikën e shëndoshë
Domosdoshmëria e hixhabit në natyrën fiziologjike humane
Islami e njeh tërheqjen fiziologjike mes dy gjinive të kundërta humane
Epshi njerëzor është asnjans dhe moskontrollimi i tij sjell rrënimin
Domosdoshmëria e hixhabit në mirëqenien sociale
Zhveshja shpie në shpërbërje të familjes, anarki dhe shtazëri
Hixhabi konsolidon etikën e lartë dhe modestinë
Mirazhi i mirëqenies femërore në botën që injoron hixhabin
Domosdoshmëria e hixhabit në logjikën e shëndoshë
Zhveshja nga hixhabi përbën zhvlerësim, ndërsa veshja e tij fisnikëri
Spekulimet me hixhabin janë joparimore dhe për interesa të ngushta
Realiteti i tretë: Aspekte të spikatura juridike islame mbi hixhabin
Dispozita të hixhabit
Kapërcimi i barrierës së mosveshjes së hixhabit nga turpi
Dy pyetje të shpeshta në lidhje me hixhabin



Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimi absolut i takon Allahut! Mëshira, lavdërimi
edhe paqja qofshin mbi të Dërguarin e Allahut!

REALITETI I PARË:

Hixhabi në qytetërimet e hershme dhe ligjet hyjnore

Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave të
qytetërimeve të hershme dhe për më tepër brenda kornizave
ligjore hyjnore të Hebraizmit, Krishterimit dhe Islamit



SË PARI:

Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave të qytetërimeve të hershme

Domosdoshmëria e hixhabit (mbulesës fetare të femrës) është brenda kornizave të qytetërimeve të hershme, në të cilat ai nuk ka qenë aspak dukuri e re.

Më konkretisht, kjo mbështetet në realitetet në vijim:

Hixhabi në qytetërimet e hershme

Shamia e kokës së gruas nuk është risi apo dukuri e re, që e ka zanafillën prej Kuranit dhe Muhamedit (Paqja qoftë mbi të), por ajo është një çështje parimore, të cilën e kanë mbështetur edhe qytetërimet që nuk kanë jetuar sipas parimeve qiellore.

Në Perandorinë Romake, gruaja e lirë, e fisme dhe elitare vishej e mbuluar dhe vetëm skllavja nuk mbulohej, sepse në fakt nuk e kishte të mundur të mbulohej. Tipari dallues i grave të respektuara (të fisme) ishte pikërisht mbulimi i kokës, i cili bëhej ose me ferexhe ose me shami koke. Kjo formë u diktonte burrave në publik, se nuk u lejohej t'u qaseshin këtyre grave dhe se çdo ngacmim i tyre

kushtonte vërtet shtrenjt.”⁶

Jo vetëm kaq, por në shoqërinë romake të disa shekujve para shfaqjes së Krishterimit, ligjet në fuqi ia kishin ndaluar gruas, që të dilte e zbukuruar në rrugë. Një prej këtyre ligjeve ishte edhe ligji i famshëm “Lex Oppia”, që ia ndalonte gruas ta tepronte në çështjen e zbukurimit, madje edhe brenda në shtëpi.

Po kështu, në traditën greke të së njëjtës kohe, femra e lirë fisnike qëndronte brenda ambienteve të shtëpisë dhe veshja e saj më e shquar - që njihej me emrin “peplum” - ishte e tillë, që gruaja e hidhte përsipër kokës së saj dhe ajo varej poshtë, duke mbuluar tërë trupin, aq sa prej trupit të saj nuk mund të shquhej asgjë. Po kështu greket e kishin zakon, që në vendet publike bashkë me trupin të mbulonin edhe fytyrën dhe prej trupit të gruas të mos dukej asgjë, përveç një syri të vetëm.⁷

Veshja mbuluese e femrës ishte evidente edhe për popujt e tjerë të kohës si: babilonasit, persët, indianët e Azisë, asirianët etj. Veshja e femrës arabe me ferejhe (rrobë që mbulon trupin dhe kokën) spikaste gjithashtu në kohët paraislamike.⁸

⁶ - A. Rousselle, ‘Body Politics in Ancient Rome,’ in G. Duby and M. Perrot, eds. *A History of Women in the West, I: From ancient Goddesses to Christian Saints*, Cambridge, Mass.: Harvard, 1992, p.315, D. B. Martin, *The Corinthian Body*, New Haven: Yale University Press, 1995, 229-249 (Quoted by, Anthony C. Thiselton, *The First Epistle to the Corinthians: a commentary on the Greek Text*, Michigan: Wm. B. Eerdmans Publishing, 2000, 801.

⁷ - Charles Hodge, *Commentary on the First Epistle to the Corinthians*, Michigan: Wm. B. Eerdmans Publishing, 1994, p.209.

⁸ - Shih: Alvin J. Schmidt, *Veiled and Silenced, How Culture Shaped Sexist Theology*, Georgia: Mercer University Press, 1990., p. 112 dhe Sami Amiri, *El-Hixhabu Sheriatullahi fil Islam, uel Jehudije uen Nasraniye*, f. 67.

Hixhabi është karakteristikë e mësimeve hyjnore të të gjitha kohërave

Në fakt shamia e kokës së femrës nuk është risi (dukuri e re), që e ka zanafillën prej Kuranit dhe Muhamedit (Paqja qoftë mbi të), por ajo është një çështje parimore, të cilën e kanë theksuar edhe librat hyjnorë të mëparshëm... Librat fetarë para Kuranit e kanë përmendur shpesh hixhabin (mbulesën fetare të gruas)...

Një detaj tejet i rëndësishëm është edhe fakti, se hixhabi islam erdhi, jo si vijimësi e mbulesës së gruas arabe të asaj kohe, por si vijimësi e mbulesës së femrave të dëlira besimtare të të gjitha kohërave.

Ndryshe nga hixhabi sheriatik (ligjor fetar), hixhabi i femrave të lira dhe të fisme arabe të asaj kohe - kur zbriti obligimi hyjnor për hixhabin (mbulesën fetare të gruas) - ishte i tillë, që në përgjithësi femrat i zbulonin qafat e tyre dhe nxirrnin në pah stolitë e vendosura në to...

Zbulimi i hireve të trupit të femrës është risi e rendit shoqëror të dekadave të fundit

Po të kthesh pas shiritin e fotove dhe filmimeve reale, dokumentare apo artistike, që u referohen vetëm pak dekadave më parë - madje edhe shumë më parë - bëhesh dëshmitar i faktit, se jo vetëm veshja e femrës fisnike shqiptare, por edhe veshja e femrës perëndimore apo edhe më gjerë, ka qenë kaftani (veshje që mbulonte tërësisht trupin dhe flokët), që në fakt është sot e kësaj dite veshje evidente e monarkeve bashkëkohore...

Ishte pikërisht “dara” komunisto-kapitaliste, e cila e nxori femrën nga fortifikata e dinjitetit, fillimisht përmes zhveshjes trupore dhe më pas për inerci edhe asaj morale; aq sa erdhi një ditë, kur media e shfrenuar e serviri shndërrimin e femrës në makineri seksi dhe pune si “çlirim të saj”, ndërsa veshjen që mbulonte trupin e femrës dhe fortifikonte moralet e saj e propagandoi (stisi) si “robërim të saj”...

SË DYTË:

**Domosdoshmëria e hixhabit është brenda
kornizave ligjore hyjnore të Hebraizmit,
Krishterimit dhe Islamit**

Domosdoshmëria e hixhabit (veshjes fetare të gruas) është gjithashtu brenda kornizave të ligjeve hyjnore të mëparshme; më konkretisht në lidhje me përmendjen e fuqishme të hixhabit (mbulesës fetare të gruas) në shoqëritë që kanë zbatuar librat e shenjtë, ajo që mund të thuhet është si vijon:

FAKTI I PARË: HIXHABI NË SHOQËRINË HEBRAIKE

Dekretimi i hixhabit në Hebraizëm

Hixhabi (mbulesa/rroba fetare e gruas, ku përfshihet edhe mbulesa e kokës) ka qenë traditë e hershme parimore e besimit hebre, që nga koha e Ibrahimit (Paqja qoftë mbi të) dhe vijoi të jetë përgjatë gjithë historisë së profetëve të tyre. Kjo mbulesë mbeti një prej bazave dhe obligimeve fetare hebraike edhe pas shfaqjes së Krishterimit, madje gratë e besimit hebre kanë veshur hixhabin (mbulesën fetare të gruas) edhe në Evropë deri në shekullin XIX. Vetëm pas kësaj kohe ato e zëvendësuan mbulimin e flokëve me paruke dhe disa sekte hebreje

e përdorin këtë formë edhe sot e kësaj dite. Gratë hebreje jo vetëm që i mbulonin flokët e tyre, por kur dilnin jashtë (në publik), e mbulonin krejt trupin e tyre në një mënyrë të garantuar. Ato dilnin patjetër të mbuluara në publik e po ashtu edhe në tempull shkonin të mbuluara dhe jo zbuluara.⁹

Më konkretisht në mëse një rast në Dhjatën e Vjetër gjejmë të përmendur mbulesën (vellon) fetare të gruas, si në fragmentet në vijim:

Në librin e Zanafillës lexojmë këto fragmente:

“24:16 Vajza ishte shumë e bukur, e virgjër dhe asnjë burrë nuk e kishte njohur kurrë. Ajo zbriti në burim, mbushi shtambën e saj dhe u ngjit përsëri lart.”

“24:64 Edhe Rebeka ngriti sytë dhe pa Isakun; atëherë zbriti me të shpejtë nga deveja, 24:65 dhe i tha shërbëtorit: “Kush është ai njeri, që vjen nga fusha drejt nesh?”. Shërbëtori u përgjegj: “Është zotëria im”. Atëherë ajo mori vellon dhe u mbulua.”

“38:14 Atëherë ajo (Tamara) hoqi rrobat e saj të vejërisë, u mbulua me një vello dhe u mbështoll e tëra...”

Në librin Isaia gjejmë:

“3:16 Zoti thotë akoma: “Duke qenë se vajzat e Sionit janë fodulle dhe ecin qafëpërpjetë dhe me vështrime provokuese, duke ecur me hapa të vegjël dhe duke bërë të tringëllojnë unazat që mbajnë te këmbët e tyre, 3:17 Zoti do të godasë me zgjebe majën e kokës së vajzave të Sionit dhe Zoti do të nxjerrë në shesh turpet e tyre”. 3:18

⁹ - John Duncan Martin Derrett, *Studies in the New Testament: Glimpses of the Legal and Social Presuppositions of the Authors*, Leiden: Brill, 1977, p.171.

Atë ditë Zoti do të heqë stolinë e unazave të kyçeve të këmbës, diejtë e vegjël dhe hënëzat, 3:19 vathët, byzylykët dhe velot...”

Dr. Bronner, në studimin e saj mbi historinë e hixhabit (mbulesës/ rrobës fetare të gruas) në shoqëritë hebraike, thotë: “Ungjilli i pasqyron flokët (e gruas) si stoli, që e hijeshon pamjen e jashtme të gruas. Ai e shpreh në formë poetike gravitetin e flokut të gruas, në Kantikun e Kantikëve të librit të shenjtë: ‘6:5 Largo nga unë sytë e tu, sepse më turbullojnë. Flokët e tu janë si një kope dhish, që kullosin mbi malin e Galaadit.’ Talmudi (enciklopedia e shenjtë hebraike), nuk e konsideron flokun e grave vetëm si të bukur, por edhe si sensual; ndaj del si obligim mbulimi i tij.”¹⁰

Dhjata e Vjetër përfshin një sërë shkrimesh të shenjta, që tregojnë me fjalë të qarta, se hixhabi (mbulesa fetare e gruas) ka qenë normë hyjnore obligative për gruan. Këto tekste ishin të njohura për dijetarët rabinë (hebre), të cilët nisur nga konteksti përgjithësues i këtyre shkrimeve dekretuan normën e obligimit të hixhabit (mbulesës fetare) për gruan hebreje. Normat ligjore hebraike i dhanë rëndësi të drejtpërdrejtë veshjes së gruas në përputhje me dispozitat ligjore të shkrimeve të shenjta hebraike, falë ndikimit të saj të sigurt në sjelljen e dëlirë... Mbarë shoqëritë tradicionale hebraike u angazhuan me ruajtjen e këtyre dispozitave... aq sa nëse gruaja hebreje zbulonte qoftë edhe një pëllëmbë nga trupi i saj, një gjë e tillë konsiderohej veprim i shturur...¹¹

¹⁰ - Dr. Leila Leah Bronner, “From veil to wig: Jewish women’s hair covering”, From: Judaism: A Quarterly Journal of Jewish Life and Thought 22/9/1993.

¹¹ - Shih: Menachem M. Brayer, The Jewish Woman in Rabbinic Literature: A psychological Perspective, Hoboken, N.J.: Ktav Publishing House, 1986, p.139.

Konsensusi i teologëve hebrej mbi hixhabin

Në këndvështrimin e juristëve të teologjisë hebraike, hixhabi (mbulesa fetare e gruas) përbën një tipar karakteristik për gruan hebreje, një udhëzim moral të shquar dhe të përparuar, që e dallon atë nga gratë e tjera. Për këtë arsye, Vilna Gaon në interpretimin që i bën këtij konteksti në Gemara (seksioni i dytë i Talmudit ku vijnë interpretime të rabinëve) thotë: “Nuk është udhë e vajzave izraelite, që të ecin kokëzbuluara në rrugë.”¹² Jo vetëm kaq, por këta klerikë e kanë konsideruar veshjen e hixhabit (mbulesës fetare të gruas) si diferencim mes gruas hebreje dhe asaj pagane, mbështetur në tekstin në vijim: “Vetëm paganet dalin kokëzbuluara.”¹³

Së këtejmi bëhet i qartë fakti, se në Hebraizëm, zbulimi i gruas është përtej limiteve të lejuara fetare dhe përbën një vepër të dënueshme, madje konsiderohet prej praktikave të ulëta pagane...

Rabini i shquar hebre - Mayer Schiller - ka sjellë konsensusin e klerit të juristëve hebrej mbi dispozitën e obligimit të mbulimit të flokëve për gruan hebreje. Më konkretisht ai thotë: “Duket qartë, se nuk ka asnjë burim juridik (dekret ose jurist) të pranueshëm (të miratuar), që e lejon gruan e martuar hebreje, që të zbulojë tërësisht flokët e saj në vendet publike.”¹⁴

Të njëjtën gjë thekson edhe rabini i shquar Getsler Ellinson, i cili më konkretisht thotë: “Të gjitha autoritetet (shkencore teologjike hebraike) kanë rënë dakord në formë të plotë, se gruaja (hebreje) e martuar është e obliguar, që të mos dalë nga shtëpia me flokë të zbuluara, ndërsa mospajtim mendimesh ka vetëm për detajet e kësaj dispozite ndaluese... Në realitet shumica e autoriteteve (shkencore teologjike hebraike), në çështjen e daljes (së gruas) me flokë të

¹² - M. Schiller, op. cit., pp. 85-86.

¹³ - Midrash, The Numbers, v. 9, p. 16.

¹⁴ - M. Schiller, op. cit., p. 104-105.

zbuluar, janë të mendimit se një gjë e tillë përbën shkelje të ligjit teuratik (të Toras/Dhjatës së Vjetër).¹⁵

Për më tepër në Talmud (enciklopedia e shenjtë hebraike) vjen qartë fakti, se floku i femrës konsiderohet pjesë intime e femrës së rritur (që duhet mbuluar). Mbi këtë fakt kleriku i shquar hebre - Jacob Meir - thotë: “Teksti i shenjtë ‘Floku i gruas është pjesë intime’ argumenton, se shikimi tek floku i gruas përbën një akt normativ.”¹⁶

Rabini i shquar - M. Schiller - thotë: “Asnjë poskim (teolog hebre gjyqtar i çështjeve fetare bashkëkohore) nuk thotë, se ndryshimi i traditave mund të shpjerë në lejimin e gruas, që të zbulojë flokët e saj.”¹⁷

Hezekieho (rabin i shquar fjalët e të cilit janë regjistruar në Talmud) ka thënë: “Mallkimi qoftë mbi çdo burrë, që lejon gruan e tij të zbulojë flokët e saj. Kjo (mbulesa e flokëve të gruas) është pjesë e dëlirjes së familjes.”¹⁸

“Gruaja hebreje kokëzbuluar, në periudhën e Tannaitikëve (guvernatorëve klerikë hebrenj, fjalët e të cilëve u regjistruan në Talmud), konsiderohej se kishte përdhosur rigorizitetin e saj fetar dhe nëse ajo dilte kokëzbuluar, do të gjobitej me 400 zosem për këtë shkelje ligjore.”¹⁹

¹⁵ - G. Ellinson, Women and Mitzvot: The Modest Way, A Guide to the Rabbinic Sources, Jerusalem: Feldheim Publishers, 1992, p.121.

¹⁶ - Shih: R. Menahem b. Benjamin Recanati, Sefer Recanati (Petrokov, 1894), sec.26 (Quoted by, Shmuel Herzfeld, Searching for Sources of the Zohar: A Woman's Headcovering) dhe Saul J. Berman, Kol Isha, New York: Ktav Publishing House, 1980, p.56.


¹⁷ - M. Schiller, op. cit., p. 97.

¹⁸ - Shmuel Herzfeld, op. cit. Zohar III, 125b.

¹⁹ - Menachaem M. Brayer, op. cit., p.139.

Hixhabi bashkëkohor tek besimtarët e përkushtuara hebreje

Në kohët moderne, disa prej grave fetare të përkushtuara hebreje preferojnë mbulimin tërësor të flokëve të tyre me shami në vend të parukeve (si në Hungari). Disa të tjera e mbulojnë kokën me shami dhe lënë në pjesën e përparme të kokës paruke të pjesshme që duket se janë artificiale (si në Ukrainë), ndërsa disa të tjera e mbulojnë kokën me paruke (si në Poloni, Lituani dhe Gjermani); ndërsa në Jemen vishen me kaftan si të martuarat, ashtu edhe beqaret.²⁰



Portrete të formës së mbulesës së femrave hebreje,
ku vërehet mbulesa e kokës dhe fytyrës

²⁰ - M. Schiller, op. cit., 102-103 dhe The Oxford Dictionary of the Jewish Religion, p.180.

FAKTI I DYTË: HIXHABI NË SHOQËRINË E KRISHTERË

Dekretimi i hixhabit në Krishterim

Krishterimi predikon gjithashtu obligimin e hixhabit (mbulesës/ rrobës fetare të gruas), përmes gojës së Jezusit/Isait (Paqja qoftë mbi të), i cili tek Mateu (5:17) thotë, se ai nuk erdhi për të ndryshuar ligjin e Moisiut/Musait (Paqja qoftë mbi të), por erdhi për ta përmbushur atë.

Më konkretisht lidhur me këtë, në librin Korintasit I gjejmë: “11:5 Edhe çdo grua, që lutet ose profetizon kokëzbuluar, turpëron kokën e saj, sepse është njëlloj sikur të ishte e rruar. 11:6 Sepse në qoftë se gruaja nuk mbulohet, le t’ia presin flokët; por në qoftë se për gruan është turp të qethet a të rruhet, le të mbulojë kokën”; pra në këtë tekst ungjillor që i përket Palit, femra e krishterë duhet të mbulohet brenda në kishë dhe a priori (rrjedhimisht) ajo është më parësore që të mbulohet jashtë saj, ku sprovat janë më të mëdha. Po kështu, bazuar në tekstin e mësipërm ungjillor, femrës që nuk e mbulon kokën e saj, duhet t’i rruhen flokët.

Logjika në fjalë argumentohet fuqishëm në thënien e John Chrysostom (një prej shenjtorëve të shquar të kishës), i cili në lidhje me mbulesën fetare të gruas jashtë kishës thotë: “Faktikisht Pali nuk i ka urdhëruar burrat, që ta zbulojnë vazhdimisht kokën e tyre, por vetëm gjatë faljes së tyre, teksa ai e urdhëroi gruan që të jetë e mbuluar gjatë gjithë kohës... Përdërisa rruajtja e flokëve të gruas është gjithmonë poshtëruese, së këtijmi vërtetohet se zbulimi i flokëve nga ana e saj konsiderohet çështje, që meriton t’i tërhiqet gjithmonë vërejtje (edhe në vendet publike jashtë kishës).”²¹

²¹ - The Homilies of St. John Chrysostom, Archbishop of Constantinople, Tr; members of the english church, Oxford: John Henry Parker, 1845, p. 356.

Po në këtë kontekst vijnë edhe fjalët e Dio Chrysostomit (filizof dhe historian bashkëkohës i Palit), në kronikat e të cilit theksohet: “Gratë në Tarsus (krahinën e Palit), e mbulonin veten e tyre kur ishin në rrugë dhe prej tyre nuk shihej asgjë.”²²

Në librin e njohur të enciklopedisë katolike, të titulluar “The Apostolic Constitutions”, i cili i përket shekullit IV dhe konsiderohet nga kisha ortodokse egjiptiane si burim i parë i ligjit hyjnor, lexojmë: “Kur të jesh në rrugë, mbuloje kokën tënde, sepse me këtë mbulim ti (si grua) ruhesh (mbrohesh) që mos të të shohin ata që bredhin rrugëve.”²³

Në librin “Trashëgimia apostolike” thuhet, se hixhabi (mbulesa fetare) që i obligohet gruas ta veshë gjatë adhurimit, duhet të jetë medoemos i trashë: “Jo thjesht një copë pëlhurë e hollë liri, sepse ky nuk është mbulim.”²⁴ Në lidhje me citatin e mësipërm, autori i librit “The Origins of Christianity”, thotë: “Obligimi i gruas këtu, që të veshë mbulesën (fetare), duket se është për çdo kohë; pra ai nuk është specifik vetëm për meshën.”²⁵

Konsensusi i teologëve të krishterë mbi hixhabin

Obligimi i veshjes së gruas së krishterë me hixhab (mbulesë fetare)

²² - Dio Chrysostom, Discourse 33.48 (Quoted by, Karen L. King, ed. Images of the Feminine in Gnosticism, Pennsylvania: Continuum International Publishing Group, 2000, p. 277.

²³ - Alvin J. Schmidt, op. cit., 135.

²⁴ - Hippolytus, On the Apostolic Tradition, tr. Alistair Stewart-Sykes, New York: St Vladimir's Seminary Press, 2001, p. 104.

²⁵ - Charles Bigg, The Origins of Christianity, Oxford: Clarendon Press, 1909, p. 279.

është një dispozitë kishtare, që gëzon konsensusin e etërve dhe shenjtorëve të kishës, gjë që theksohet nga një sërë historianësh të shquar të Krishterimit. Më konkretisht lidhur me këtë, kritikja Joyce E. Salisbury thotë: “Floku i gruas ishte simbol dhe tregues i tiparit të saj seksual dhe gjinor, gjë që i bëri etërit e kishës të thonë gjithmonë, se gratë e kanë obligim t’i mbulojnë kryet e tyre.”²⁶

Etërit më të mëdhenjt të Krishterimit e obligojnë mbulesën fetare të gruas

Tertuliani (i konsideruar si ati i kishës latine) në lidhje me mbulesën fetare të gruas thotë: “Gruaja e dëlirë është e obliguar që ta veshë kaftanin (mbulesën fetare të gruas) në rrugë, ashtu si në kishë, pa dallim ... Ashtu siç asaj i kërkohet ta veshë kaftanin për arsye të engjëjve, po kështu i kërkohet që ta veshë atë për arsye të burrave, që ata të mos sprovohen (provokohen) prej saj.”²⁷

Klementi i Aleksandrisë (prej teologëve më të shquar të krishterë të kohës së tij) në lidhje me mbulesën fetare të gruas thotë: “Gruaja duhet medoemos ta mbulojë krejtësisht trupin e saj, kur nuk është në shtëpi, sepse ky model i veshjes është i respektuar dhe e mbron fizikun e saj nga shikimet përcëlluese të syrit... Po kështu, përmes mbulimit të fytyrës së saj, ajo nuk i thërret (fton) të tjerët, që të bien në mëkat.”²⁸

²⁶ - Joyce E. Salisbury, *Church Fathers, Independent Virgins*, London: Verso, 1992, 105e.

²⁷ - *The Ante-Nicene Fathers*, 1885, 4/35.

²⁸ - Tertullian, ‘the Instructor,’ in *The Ante-Nicene Fathers*, Buffalo: christian Literature Company, 1885, 2/290.

Shën Augustini (shenjtori më i shquar i kishës perëndimore) në lidhje me mbulesën fetare të gruas thotë: “Gruaja e ka obligim ta mbulojë trupin e saj, përfshirë kokën...”²⁹

Në të njëjtën linjë janë edhe etër e shenjtorë të tjerë të shquar të Krishterimit, prej të cilëve Joan Gojarti (John Chrysostom që e cituam më sipër), Abroseu (peshkop i famshëm i Milanos), Tomas Akuini (teolog shumë i shquar i Mesjetës, shumë i ndikuar nga trashëgimia teologjike e Shën Augustinit) etj.

Enciklopedia Elektronike Britanike e viti 2008, në lidhje me termin “Wimple/shami koke” përmend: “Shumica dërmuese e grave evropiane nga fundi i shekullit XII deri në fillimin e shekullit XIV, visheshin me shami koke, e cila ua mbulonte kokën dhe u mbështillej rreth fytit, faqeve dhe mjekrës; të ndikuara në këtë [siç thotë kjo enciklopedi] nga muslimanet, pas kthimit të ushtarëve të kryqëzatave nga vendet muslimane”³⁰. Kjo formë veshjeje nuk binte në kundërshtim e për më tepër pajtohej tërësisht me urdhrat e trashëgimisë kishtarë dhe ato në fuqi, prandaj edhe ky model i importuar nga bota islame gjeti zbatim.

Hixhabi bashkëkohor tek besimtarët e përkushtuara të krishtera

Për të parë rëndësinë e mbulesës fetare të gruas në Krishterim, mjafton të shohim murgeshat, të cilat sot e kësaj dite jo vetëm mbulojnë flokët, por veshin një rrobë gati të ngjashme me atë të muslimaneve. Po të mos ishte mbulesa fetare e gruas diçka e

²⁹ - Alvin J. Schmidt, Op. Cit., p. 134.

³⁰ - Wimple.” Encyclopædia Britannica. 2008. Encyclopædia Britannica Online Library Edition. 11 July 2008 <<http://library.eb.com/eb/article-9077146>>.

rëndësishme në Krishterim, murgeshat nuk do të ishin të obliguara me këtë veshje brenda dhe jashtë kishës.

Në librin e Timoteut të Dhjatës së Re, tregohet qartë fakti se si Krishterimi jo vetëm e urdhëron gruan të mbulohet me veshjen e saj fetare, por e ndalon atë që të ekspozohet para të huajve me çdo lloj stolie të jashtme:

“2:8 Në mënyrë të njëjtë dua që edhe gratë të vishen hijshëm, me cipë e modesti dhe jo me gërsheta a me ar, a me margaritarë, a me rroba të shtrenjta, 2:9 po me vepra të mira, si u ka hije grave që i kushtohen perëndishmërisë”.

Për më tepër, prej normave fetare të kishës katolike të sotme, është obligimi i femrave, që në kishë të hyjnë medoemos kokëmbuluara (me shami).³¹

Po kështu gratë e përkushtuara të disa sekteve të krishtere, si p.sh. ai Menonit dhe Amish, sot e kësaj dite qëndrojnë me kokë të mbuluar, bazuar në mësimet e krerëve të kishës së tyre, me motivin se mbulimi i kokës është simbol i nënshtimit ndaj burrit dhe Zotit, pra [referuar tek] i njëjti koment që jep Pali në Dhjatën e Re...³²

Në librin e mësimi fetar të kishës katolike lexojmë: “Pastërtia/ Dëlirja obligon modestinë... modestia mbron rrethin intim të personit. Kjo do të thotë refuzim i zbulimit të asaj që duhet të mbetet e mbuluar. Modestia e inspiron personin, që ta zgjedhë


³¹ - Shih: Clara M. Henning, “Cannon Law and the Battle of the Sexes” in Rosemary R. Ruether, ed., Religion and Sexism: Images of Woman in the Jewish and Christian Traditions, New. f. 272. New York: Simon and Schuster 1974; Donald B. Kraybill, The riddle of the Amish Culture, Baltimore: Johns Hopkins f. 56, University Press 1989.

³² - Shih: Donald B. Kraybill, The riddle of the Amish Culture, Maryland: JHU Press, 2001, revised edition, pp.60-63.

veshjen e tij. Modestia e ndjenjave është fakt i pranishëm, sikundër edhe modestia e trupit. Pastërtia/Dëlirja kristiane kërkon gjithashtu dëlirjen e mjedisit social.”³³

Argument

Gjithashtu, në po këtë kontekst duhet t’i kushtohet vëmendje edhe faktit, se portreti i Marias/Merjemes (Allahu qoftë i kënaqur me të), nënës së Jezusit/Isait (Paqja qoftë mbi të), në ikonat origjinale të krishtere, është pikturuar gjithmonë me mbulesë, gjë që mbështet bindshëm faktin, se mbulesa fetare e gruas është një veçori themelore fetare në Krishterim...



Perëndimit të krishterë që mëkon (ushqen) sulmuesit e hixhabit (mbulesës fetare) të muslimanes, për çudi nuk i bën asnjë përshtypje fakti, se ata vetë (pra perëndimorët) i kanë mbushur shtëpitë dhe faltoret e tyre me portretet e Marias, nënës së Jezusit, e cila në versionet e ikonave të saj origjinale paraqitet qartë e veshur me

³³ - Catechism of the Catholic Church, D.C.: USCCB Publishing, 2000, 2nd edition, p. 604, nr. 2521-2525.

rrobën e gruas muslimane dhe mban të hedhur mbi vete kaftanin e saj, që ia mbulon kokën dhe tërë trupin... E si pra kanë ata sy e faqe ta vënë në lojë hixhabin e muslimanes?! Nëse janë vërtet të drejtë e të paanshëm siç pretendojnë, le të tallen pra me nënën e zotit të tyre, e cila mban veshur po atë veshje, që e veshin edhe muslimanet!!

Perëndimit të krishterë që mëkon (ushqen) sulmuesit e hixhabet (mbulesës fetare) të muslimanes, për çudi nuk i bën asnjë përshtypje gruaja e krishterë (murgesha) e mbuluar fizikisht dhe shpirtërisht nën veshjen kishtarë. Murgesha e ka privuar veten e saj nga të mirat e kësaj bote, me qëllim që në amshim ajo të bëhet nusja e Mesihut/Jezusit, sipas vetë vendimit të saj të shfaqur në formulën e murgeshës: “Martesa (shpirtërore) ka prikën, të cilën e paguan murgesha, nusja e vërtetë e Jezu Krishtit, falë shenjtërisë së statusit (pozitës) të saj”...³⁴

Shikojeni standardin e dyzuar, sesi gruaja e krishterë nuk konsiderohet shkelëse dhe tradhtarë e sensualitetit natyral të saj, por vlerësohet si një grua që ka zgjedhur veshjen dhe jetesën që i ka korresponduar mendimit të saj; kurse muslimanet - teksa jeta e tyre e dëlirë sensuale është më e gjallë se e çdo femre tjetër, dekretuar kjo me vulën e ligjit hyjnor islam - shigjetohen dhe etiketohen me ekstremizëm dhe manerizëm (ndrydhje)...

A mund të jetë gjykimi i mësipërm perëndimor rezultat i një mendimi të balancuar dhe të paanshëm, kur në vend që perëndimorëve t’u ngjallë neveri murgjëria që mbulon mishin dhe ndëshkon shpirtin me kamxhikët e privimit, për çudi perëndimorët e quajnë të kobshëm mbulimin e mishit/trupit (pra hixhabin e muslimanes) që nuk pengon asnjë mirësi dhe nuk privon nga

³⁴ - Saint Alphonso Liguori, True Spouse of Jesus Christ or The Nun Sanctified by the Virtues of her State, Dublin: John Coyne, 1835.

asnjë kënaqësi bazë (sensuale dhe më gjerë)?! A nuk kemi të drejtë ne muslimanët, që t'ua shtrojmë mbarë të krishterëve pyetjen e arsyeshme: “Cila është më e logjikshme, thënia e katolikëve dhe ortodoksëve, se murgesha i mbulon flokët e saj dhe vesh kaftanin e gjerë me ngjyrë të errët, ngase ka bindjen se kësisoj në amshim do të jetë gruaja/nusja e zotit të saj Krishtit; apo thënia e muslimanëve se mbulimi i gruas është urdhër dëlirësimi për çdo grua të devotshme, që synon mosprovokimin e burrave nga ngacmimet e ndaluara femërore dhe ruan virtytin në botën njerëzore?!”

Në një debat mes një muslimani me një të krishter, ndër të tjera i krishteri i thotë muslimanit: “Mendoj se dy gjëra janë të pashpjegueshme në Islam: 1- fakti që femra muslimane i mbulon flokët me shami dhe 2- fakti që burrat mbajnë mjekër!” Muslimani e pyeti: “A nuk më thua, përse murgeshat mbajnë shami në kokë dhe prifti ortodoks mban mjekër?” I krishteri ia ktheu: “Epo ata janë elitë fetare.” Atëherë muslimani tha: “Nuk është faji im, se përse përkushtimi i muslimaneve dhe muslimanëve të thjeshtë tek ne, është në nivelin e elitës së krishterë.”

Hixhabi vijohet, përvijohet dhe përmbushet nga Islami

Kësisoj bëhet i qartë fakti, se hixhabi (mbulesa fetare e gruas) nuk është një shpikje e Islamit, por Islami vetëm sa e vijoi dhe e përforcoi këtë parim hyjnor...

Sidoqoftë, ndryshe nga Krishterimi që e ligjëroi hixhabin (mbulesën fetare të gruas) si nënshtrim të gruas ndaj burrit (sikurse thuhet në librin Korintasit I: “11:7 Sepse burri nuk duhet të mbulojë kryet, sepse është shëmbëllimi dhe lavdia e Perëndisë, kurse gruaja është lavdia e burrit, 11:8 sepse burri nuk është nga gruaja, por gruaja nga burri, 11:9 edhe sepse burri nuk u krijua për gruan,

por gruaja për burrin”), apo ndryshe nga Hebraizmi që e ligjëroi hixhabin (mbulesën fetare të gruas) si simbol të mirëqenies dhe vlerës shoqërore; pra ndryshe nga Krishterimi dhe Hebraizmi, feja islame e ligjëroi hixhabin (mbulesën fetare të gruas) për një qëllim të qartë, siç përmendet në ajetin kuranor, ku Allahu i Madhëruar thotë: **“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit [të lëshojnë mbi vete hixhabin/kaftanin (mbulesën fetare të gruas)]. Kjo është mënyra më e përshtatshme, që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**³⁵ Vëreni se si Allahu e mbyll këtë ajet me atributet e Tij “Falës dhe Mëshirëplotë”, që do të thotë, se besimtaren që angazhohet me zbatimin e urdhrave të Tij, Allahu i Madhëruar do ta falë për gabimet e saj të mëparshme dhe se sqarimi i hallallit dhe haramit në veshje e çdo gjë tjetër, është mëshirë, me të cilën Allahu i ka mëshiruar besimtarët dhe besimtarët...

³⁵- Kuran, El-Ahzab: 59.

SË TRETË:

**Domosdoshmëria e hixhabit është brenda
kornizave ligjore hyjnore islame**

Domosdoshmëria e hixhabit (mbulesës fetare të gruas) është brenda kornizave të ligjit hyjnor të urtë ideal islam.

FAKTI I PARË: DISPOZITA E HIXHABIT NË ISLAM

Hixhabi (mbulesa fetare e gruas) është obligim hyjnor i obliguar nga Kurani, Suneti autentik (tradita profetike) dhe Ixhmaja (konsensusi/unifikimi i të gjithë dijetarëve muslimanë) pa asnjë përjashtim dhe për këtë fakt nuk ka asnjë kundërshtim mes muslimanëve.

Obligimi i hixhabit mbështetur në argumentet kuranore

Hixhabi (veshja/rroba fetare e gruas muslimane) është obligim sheriatik hyjnor dhe gruaja obligohet ta veshë atë, kur del nga

shtëpia e saj, apo në ambientet ku ka burra që nuk janë mahrem³⁶ i saj, por janë të huaj për të.

Hixhab konsiderohet çdo veshje, që e mbulon tërë trupin e femrës - me përjashtim të fytyrës dhe pëllëmbëve të duarve nga kyçet deri tek gishtat dhe - sipas disa mendimeve - këmbëve nga kyçet (nyjat) e poshtë³⁷, me kusht që kjo veshje:

1- Të mos jetë zbukurim në vetvete, të mos jetë e hollë dhe e tejdukshme, të mos jetë me ngjyrë të ndezur, të jetë e bollshme (të mos shfaqë format e trupit), të mos jetë e parfumuar apo e aromatizuar.

2- Të mos u përngjajë rrobave të meshkujve, të jobesimtareve apo femrave të shthurura, si dhe të mos jetë rrobë që vishet për famë. Në

³⁶ - Mahrem: Çdo mashkull me të cilin femrës i ndalohet përjetësisht martesja; me fjalë të tjera mahrem i gruas muslimane është bashkëshorti i saj dhe çdo mashkull me të cilin asaj i ndalohet përjetësisht martesja, si babai, gjyshi, vëllai, nipi, daja, xhaxhai, njerku, thjeshtri, vjehri, dhëndri etj. (nga gjenealogjia, krushqia ose gjidhënia).

³⁷ - Dijetarët kanë mendime të ndryshme lidhur me kufirin intim trupor të gruas përpara burrave, që nuk janë mahrem për të (pra burrave me të cilët kësaj gruaje nuk i ndalohet përjetësisht martesja). Gjithsesi kufiri minimal është mbulimi i tërë trupit të gruas me përjashtim të fytyrës, dy pëllëmbëve dhe dy këmbëve (nga kyçet/nyjat e këmbëve e poshtë). Në lidhje me çështjen e mbulimit të fytyrës, dy pëllëmbëve dhe dy këmbëve, dijetarët muslimanë kanë dy mendime: 1- Një gjë e tillë është sunet/e pëlqyeshme (ka shpërblim për veprimin e saj dhe nuk ka ndëshkim për mosveprimin e saj) dhe 2- Një gjë e tillë është është vaxhib/obligim (ka shpërblim për veprimin e saj dhe ka ndëshkim për mosveprimin e saj)... Duhet theksuar gjithashtu fakti, se përjashtimi i këtushëm i dy këmbëve, në të shumtën e rasteve nuk përmendet fare në subjektet ku trajtohen mospajtimet e juristëve muslimanë mbi këtë çështje, që do të thotë se përjashtimi i këmbëve në çështjen në fjalë, përbën mendimin e një pakice juristësh muslimanë...

lidhje me këtë fakt Allahu i Madhëruar i ka urdhëruar besimtarët në Kuran me fjalët: **“Mos i zbuloni stolitë (hijeshitë) tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes [në periudhën paraislame]!”**³⁸

Po në lidhje me çështjen e mbulesës fetare, Allahu i Madhëruar u drejtohet familjareve të Profetit (Paqja qoftë mbi të) dhe mbarë muslimaneve me fjalët: **“Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë (hijeshitë) tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes [periudhën paraislame]! Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij! O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë [gjynahet] dhe t’ju pastrojë plotësisht.”**³⁹

“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”⁴⁰

Hixhabi (veshja/mbulesa fetare e gruas) është obligim hyjnor i dekretuar me tekste të shenjta kuranore, të cilat e kanë përmendur me hollësi çështjen e hixhabit dhe kanë sqaruar qartë caqet e tij, ndërkohë që tekstet juridike kuranore zakonisht vijnë me rregulla ligjore të përgjithshme dhe jo të detajuara. Ky përjashtim vjen në rastin e hixhabit, nisur nga rëndësia e madhe e tij, pasi ka të bëjë me thelbin e ndërtimit të personalitetit islam të gruas besimtare...

³⁸ - Kuran, El-Ahzab: 33.

³⁹ - Kuran, El-Ahzab: 33.

⁴⁰ - Kuran, El-Ahzab: 59.

Më konkretisht në lidhje me faktin se para kujt duhet ta veshë hixhabin (mbulesën fetare) gruaja muslimane, Allahu i Madhëruar thotë:

“Thuaje besimtareve që të ulin shikimet e tyre [nga të ndaluarat/mëkatet], **ta ruajnë nderin e tyre** [nga marrëdhëniet jashtë kurore] **dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre** [stolitë dhe pjesët e trupit ku vendosen stolitë], **përveç atyre që janë të dukshme** [fytyrës, pëllëmbëve të duarve dhe dy këmbëve nga kyçet e poshtë]. **Le t’i mbulojnë kraharorët me mbulesat e tyre** [të kokës, pra le të mbulojnë kokat, qafat dhe kraharorët e tyre] **dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse: bashkëshortëve të tyre** [sepse mbulesa në rend të parë është në interes të bashkëshortit], **ose baballarëve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe gjyshërit e besimtares nga babai dhe mamaja, e sipër], **ose vjehërrve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe babai i vjehrrit dhe vjehrrës së besimtares, e sipër], **ose bijve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe djemtë e bijve dhe bijave të besimtares, e poshtë], **ose djemve të bashkëshortëve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe djemtë e bijve dhe bijave të bashkëshortit të besimtares, e poshtë], **ose vëllezërve** [të tyre], **apo djemve të vëllezërve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe djemtë e bijve dhe bijave të vëllezërve të besimtares, e poshtë], **ose djemve të motrave të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe djemtë e bijve dhe bijave të motrave të besimtares, e poshtë], **a grave** (shoqeve) **të tyre** [muslimaneve të tjera ndër to] **ose atyre që i kanë nën zotërim** [skllaveve të tyre], **ose shërbëtorëve që nuk kanë epsht ndaj femrave, apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave.**”⁴¹

Në këtë ajet (varg) kuranor sqarohet obligimi i mbulimit të të gjitha stolive dhe apriori (rrjedhimisht) pjesëve të trupit ku vendosen

⁴¹ - Kuran, En-Nur: 31.

këto stoli, si dhe obligimi i mosshfaqjes së tyre para të huajve, përveç burrave që njihen në terminologjinë islame me termin “mahrem”, ku përjashtim bëhet vetëm për ato pjesë të trupit shfaqja e të cilave është e pashmangshme dhe nuk bëhet me qëllim provokues, që sipas mendimeve të diskutueshme të juristëve muslimanë nuk përfshijnë më shumë se fytyrën, dy pëllëmbët dhe (sipas disa mendimeve) dy këmbët (nga kyçet/nyjat e poshtë) ...

Obligimi i hixhabit mbështetur në argumentet profetike

Në lidhje me ajetin (vargun) kuranor të lartpërmendur, nëna e besimtarëve - Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) - thotë:

“Allahu i mëshiroftë gratë e para emigrante (muslimanet që emigruan të parat nga Meka për në Medine), kur Allahu zbriti: **“Le t’i mbulojnë kraharorët me mbulesat e tyre** [të kokës, pra le të mbulojnë kokat, qafat dhe kraharorët e tyre]”⁴²-, ato i grisën shtojcat e fundeve të tyre dhe u mbuluan me to [mbuluan kokat dhe fytyrat me to].”⁴³

Në këtë tekst vjen argumenti kategorik mbi faktin, se floku i gruas konsiderohet auret (pjesë intime). Së këtejmi vjen edhe arsyeja, se përse sahabet (gratë muslimane në shoqërinë e Profetit) i mbuluan kokat e tyre, kur zbriti ky ajet (varg) kuranor dhe Profeti (Paqja qoftë mbi të) e miratoi kuptimin e tyre në fjalë.

Në kuadrin e obligimit të hixhabit, mbështetur në argumentet profetike, transmetohet se Umu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të) - një nga bashkëshortet e Profetit - e ka dëgjuar Profetin (Paqja qoftë mbi të) të thotë: *“Kush e tërheq rrobën e tij me mburrje [për mendjemadhësi], Allahu nuk ka për ta parë [me mëshirë dhe për*

⁴² - Kuran, En-Nur: 31.

⁴³ - El-Bukhari 4758 dhe 4759.

mirë, por me zemërim dhe pakënaqësi] në *Ditën e Gjykimit*.” Ajo e ka pyetur: “Po si të veprojnë gratë me shtojcat fundore të rrobave të tyre [që varen përdhe]?!” Profeti (Paqja qoftë mbi të) tha: “*T’i lëshojnë një pëllëmbë.*” Ajo tha: “Kështu atyre (grave) u zbulohen këmbët [nga kyçi e poshtë].” Profeti (Paqja qoftë mbi të) tha: “*Le t’i lëshojnë një kut (parakrah) dhe jo mbi këtë.*”⁴⁴

Kjo thënie profetike përbën një argument kategorik mbi parimin, se veshja mbuluese e gruas duhet të përfshijë tërë trupin e saj, bazuar edhe në faktin se transmetuesja druhej se nëse rroba do të kishte një shtojcë të shtrirë vetëm një pëllëmbë përdhe, këmbët e gruas do mund të zbuloheshin. Vetëkuptohet se me një rrobë të tillë, femrës mund t’i zbulohet vetëm pjesa nga kyçi i këmbës e poshtë dhe jo më shumë...

Gjithashtu, në po këtë kontekst, profeti Muhamed (Paqja qoftë mbi të) thotë:

“Dy kategori prej banorëve të zjarrit nuk do t’i shoh: një popull që bart kamxhikë, sikurse bishtat e lopëve [me të cilët i keqtrajtojnë padrejtësisht njerëzit] dhe gra të veshura, por të zhveshura, që ecin dhe i mësojnë edhe të tjerat të ecin duke u anuar [me arrogancë dhe mendjemadhësi], kokat e tyre [i modelojnë me copëra dhe ngjashëm që i bëjnë të duken] si xhungat e lëkundshme të devesë. Ato s’kanë për të hyrë në Xhenet dhe as kanë për ta ndjerë aromën e tij, teksa faktikisht aroma e tij ndjehet në një distancë prej kaq e kaq [në një transmetim vjen ‘nga dyzet vite larg’⁴⁵].”⁴⁶

Përsa i përket pjesës së hadithit “ato s’kanë për të hyrë në Xhenet dhe as kanë për ta ndjerë aromën e tij” dijetarët e kanë interpretuar

⁴⁴ - En-Nesai 5336 dhe Et-Tirmidhi 1731, Albani thotë se hadithi është sahih/i vërtetë.

⁴⁵ - El-Bukhari 6914.

⁴⁶ - Sahihu Muslim 2128.

se bëhet fjalë për ato gra, që i konsiderojnë të ligjshme/të lejuara haramet kategorike hyjnore, siç është edhe mosveshja e hixhabit. Gra të tilla nuk do hyjnë kurrë në Xhenet; ndërsa ato gra që bien në këto harame, por nuk i konsiderojnë ato të ligjshme/të lejuara, do të hyjnë në Xhenet, por për shkak të mëkatit në fjalë ato fillimisht meritojnë të ndëshkohen.

Kurse për pjesën e hadithit “*të veshura, por të zhveshura*” dijetarët kanë dhënë komentet në vijim:

- a. e kanë njëren pjesë të trupit të mbuluar dhe tjetrën të zbuluar;
- b. janë të veshura, por me rroba të ngushta që i tregojnë format e trupit;
- c. janë të veshura, por me rroba transparente që lejojnë të shihet trupi i tyre;
- d. janë të veshura me rroba, por të zhveshura nga devotshmëria.

Sigurisht që muslimanja e vërtetë, pasi i dëgjon këto fjalë të Profetit të saj (Paqja qoftë mbi të), nuk e merr guximin të bjerë viktimë e këtyre vërejtjeve të rënda...

Obligimi i hixhabit mbështetur në konsensusin e juristëve muslimanë

Të gjithë juristët muslimanë që nga koha e sahabëve (shokëve të Profetit) kanë rënë dakord mbi dispozitën islame, se gruaja e lirë obligohet të vishet me hixhab, pra me rrobën fetare që duhet të mbulojë tërë trupin e saj - me përjashtim të fytyrës, dy pëllëmbëve dhe (sipas disa mendimeve) dy këmbëve [nga kyçi e poshtë] - përpara burrave të huaj, që nuk janë mahrem të saj dhe se moszbatimi i kësaj dispozite nga ana e saj përbën një mëkat të madh...

Në lidhje me konsensusin e juristëve muslimanë mbi këtë çështje thuhet si vijon:

Dijetari i shquar musliman - Ibn Hazmi - ka thënë: “Ka konsensus [mes dijetarëve muslimanë], se floku dhe trupi i gruas së lirë (e cila

nuk është skllave) - përveç fytyrës dhe dy pëllëmbëve të saj - janë auret (pjesë intime të trupit), ndërsa për fytyrën, dy pëllëmbët e madje edhe për thonjtë e tyre, dijetarët muslimanë kanë mospajtime mes tyre, nëse ato janë auret (pjesë intime të trupit) apo jo.”⁴⁷

Dijetari i shquar - Ibn Tejmije - e ka pranuar këtë konstatim të Ibn Hazmit dhe nuk ka bërë ndonjë vërejtje lidhur me të, ndryshe nga sa ka vepruar në disa raste të tjera në librin në fjalë të imam Ibn Hazmit, veçanërisht për mendimet konsensuale të dijetarëve muslimanë, që Ibn Hazmi i ka paraqitur në këtë libër.

Po në këtë kontekst, El-Xheziri thotë: “Dijetarët (muslimanë) kanë mendime të ndryshme në lidhje me përcaktimin e aurretit (pjesës intime të trupit) të gruas... Hanefitë (medh’hebi hanefi), mendimi i dytë i shafi’ive (medh’hebit shafi’i) dhe gjykimi bazë i malikive (medh’hebit maliki) është, se i gjithë trupi i gruas së lirë - përveç fytyrës dhe dy pëllëmbëve - është auret (pjesë intime e trupit); pra gruas i lejohet të zbulojë fytyrën dhe dy pëllëmbët e saj në rrugë dhe para burrave të huaj, që nuk janë mahrem për të, por ata e kanë kushtëzuar këtë lejim me garantimin e mosprovokimit...”⁴⁸

⁴⁷ - Ibn Hazmi, Maratibu El-Ixhma, f. 29.

⁴⁸ - El-Xheziri, El-Fikhu ale El-Medhahib El-Erbea, v. 5, f. 52. Në lidhje me këtë lloj mosprovokimi, dijetarët muslimanë përmendin, se femra muslimane duhet t’i frikësohet Allahut të Madhëruar dhe të mos provokohet dhe as të provokojë të tjerët, të mos sprovohet dhe as të sprovtojë të tjerët, sidomos kur çështja ka të bëjë me provokimet dhe sprovat me gjininë e kundërt, pasi burri e ka në instiktin e tij tundimin prej gruas, ashtu sikundër vlen edhe e anasjella. Më konkretisht, disa prej këtyre dijetarëve janë shprehur, se me termin “provokim a sprovë”, nënkuptohet prania e një shkakut konkret për rënien e femrës në një situatë veçimi, shtrëngimi, puthjeje apo ngacmimi seksual, nga një mashkull i huaj.

**FAKTI I DYTË: DOMOSDOSHMERIA E HIXHABIT PASQYRUAR
NË URTËSITË HYJNORE ISLAME TË OBLIGIMIT TË TIJ**

Dijetarët muslimanë kanë përmendur, se urtësitë më të spikatura të obligimit të hixhabit (rrobës/mbulesës fetare të gruas) në Islam janë:

a) hixhabi është obligim hyjnor i dekretuar nga Kurani, Suneti autentik (tradita profetike) dhe Ixhmaja (konsensusi/unifikimi i të gjithë dijetarëve muslimanë) pa asnjë përjashtim dhe në lidhje me këtë nuk ka asnjë mospajtim mes muslimanëve;

b) hixhabi në Islam u ligjësua bazuar në atributin e Allahut “Falës dhe Mëshirëplotë”,⁴⁹ që do të thotë se besimtaren që angazhohet me zbatimin e urdhrave të Tij, Allahu i Madhëruar do ta falë për gabimet e saj të mëparshme dhe se sqarimi i hallallit dhe haramit në veshje dhe çdo gjë tjetër është mëshirë, me të cilën Allahu i Madhëruar ka mëshiruar besimtarët dhe besimtarët;

c) hixhabi është fortifikata e gruas dhe piedestali i saj, që Allahu i Madhëruar e ligjësoi për ta fisnikëruar gruan besimtare dhe për ta siguruar atë prej njerëzve të këqij, prej ngacmimeve të agresorëve seksualë dhe më gjerë;

d) hixhabi është argument i nënshtrimit ndaj gjykimit (ligjit) të Zotit, angazhimit me urdhrin e Tij, qëndrimit brenda kufijve hyjnorë dhe kënaqjes me Allahun për Zot, me Islamin për fe dhe me Muhamedin (Paqja qoftë mbi të) për profet të fundit të dërguar prej Zotit;

e) hixhabi është kryetitulli i modestisë dhe simboli i dëlirjes, ndërsa me shpërfilljen apo heqjen e tij (hixhabit) femra shndërrohet

⁴⁹ - Shih: Kurani, El-Ahzab: 59.

në mall të zhvlerësuar, ia ekspozon veten abuzimeve të dhunuesve dhe bëhet bela për besimtarët dhe njerëzit mbarë.

Amina Assilmi (Allahu e mëshiroftë) – ish baptiste amerikane dhe më pas një prej ftueseve të shquara të lëvizjes së gruas muslimane në Perëndim - në fillimet e islamizimit të saj pati premtuar, se nuk do ta vishte kurrë hixhabin, por pas studimeve të thelluara islame ajo e adoptoi (pranoi dhe zbatoi) hixhabin. Ajo shprehet kështu mbi urtësinë e hixhabit:

“Vetë Kurani thotë, se përse ne (gratë muslimane) i mbulojmë flokët tona; pra ne e bëjmë këtë, që të identifikojmë vetet tona si muslimane, që të njihemi. Kjo është e para: ne e veshim këtë (hixhabin) si akt të çiltërsisë dhe vërtetësisë, që çdokush të vihet në dijeni, se ne jemi gra muslimane, sepse ne duam që të gjithë ta dinë se ne jemi gra muslimane dhe jemi krenare që jemi të tilla. Sidoqoftë, kjo veshje thotë shumë gjëra të tjera; ajo i thotë kujtdo që më shikon mua, muslimanen e veshur me të, se: ajo që gjendet para jush është një grua tepër rigoroze, kurajoze dhe me integritet të lartë; kjo grua nuk nënshtrohet dhe as manipulohet, pra ajo është punëdhënësja/punëmarrësja më e mirë, shoqja më e mirë, këshilluesja dhe diskutuesja më e mirë; kjo është grua muslimane, prandaj ju mund ta besoni atë ...

Hixhabi me dukshmërinë e tij është gjithashtu një paralajmërim, pasi ai i thotë çdokujt se ajo që gjendet para jush, është një grua e cila e di punën e saj, i di vlerat e veta, ajo nuk është një lodër, prandaj as mos e çoni ndërmend të lozni me të; kjo është një grua të cilën duhet ta marrësh shumë seriozisht.

Kësisoj, hixhabi im i bën njerëzit të dinë drejtpërdrejt, se unë dua të dallohem nga të tjerët, dua ta dini kush jam dhe në fakt është e drejta juaj, që këtë të prisni nga unë dhe kjo është ajo që unë pres nga

ju. Prandaj kur të qëndroni pranë meje, lëreni blasfeminë tuaj diku tjetër, unë nuk do e dëgjoj atë, kur të vini tek unë mos e përgojoni tjetrin, sepse unë nuk e ha mishin e vëllait tim/motrës time.

Kjo është ajo që më identifikon mua si grua muslimane dhe po të shkoj më tej, ky identitet do më thotë: ‘...ti nuk ke për t’u ngacmuar nga të tjerët.’ [Referuar në ajetin kuranor: **“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**⁵⁰”⁵¹

Nga sa u cek më sipër, jo domosdoshmërisht nënkuptohet, se nuk gjendet asnjë mirësi tek ajo femër që nuk mbulohet si duhet, por gjithsesi nuk mund të mohohet fakti, se një femër e tillë së paku konsiderohet e pakujdesshme dhe paraqitja e saj nuk është plotësisht ajo që duhet...

⁵⁰ - Kuran, El-Ahzab: 59.

⁵¹ - <https://youtube.com/watch?v=O7MyxpmMfHc> dhe <http://soundvision.com/article/who-was-aminah-assilmi>.

SË KATËRTI:

**Profeti (Paqja qoftë mbi të) model në
sjelljen me femrat, mbi të cilin zbriti
dispozita e obligimit të hixhabit**

**FAKTI I PARË: MODELI PROFETIK LEGJITIMON BOTËN
IDEALE KU NJË GRUA MUND TË JETOJË E ÇLIRUAR DHE E
DËLIRË**

“Muhamedi faktorizoi tërë kapacitetin e tij për çlirimin e grave dhe këtë e përmbushi përmes modelit perfekt që legjitimoi.”⁵²

Dr. Katherine Bullock e sqaron qartë ndryshimin thelbësor mes gjykimit mbi hixhabin (mbulesën fetare të gruas) të nxitur nga lavazhi mediatik perëndimor i trurit dhe gjykimit të bazuar në përjetimin e vlerës hyjnore të veshjes së hixhabit. Ajo thotë: “Në vitin 1991 pashë një kronikë lajmesh televizive, ku shfaqeshin gra turke që i ktheheshin veshjes së hixhabit. U shokova dhe ndjeva keqardhje për to. Thashë me vete: ‘Të

⁵² - Uasif Butrus Gali, mendimtar egjiptian i krishterë.

gjorato, u është bërë lavazh (shpërlarje) truri nga kultura e tyre e mëparshme”. Isha e bindur - si shumë evropianë të tjerë -, se Islami i persekuton gratë, ndërsa hixhabi është simboli i persekutimit të tyre. Imagjinojeni befasinë që më ndodhi pas katër vitesh, teksa e shihja veten para pasqyrës së një qendre tregtare, veshur me një rrobë që përfaqësonte tërësisht veshjen e atyre ‘grave të persekutuar’. E nisa udhëtimin tim shpirtëror në periudhën e magjistraturës dhe pas katër vitesh pranova Islamin. Ky udhëtim përfshi u në etapat e tij transformimin tim nga urrejtja ndaj fesë islame, në respektimin e Islamit dhe interesimin për të deri në pranimin e tij.”⁵³

Yvonne Ridley, gazetarja e shquar angleze që ka pranuar Islamin, pasi provoi jetën perëndimore dhe më pas atë islame, shprehet në lidhje me faktin, se cili nga këto dy modele të jetuari i dhuron gruas çlirimin e vërtetë. Ajo thotë: “Nderimi në Islam arrihet përmes devotshmërisë (përkushtimit fetar) dhe jo nëpërmjet bukurisë, pasurisë, fuqisë, pozitës apo gjinisë. Pa më thuaj tani, më çliruese është që gjykimi mbi ty (si femër) të bëhet, duke u bazuar në gjatësinë e fundit tënd dhe madhësinë e gjoksit tënd të zmadhuar kozmetikisht; apo që gjykimi mbi ty të bëhet bazuar në personalitetin, mendjen dhe inteligjencën tënde?! Revistat e lustruara na thonë ne grave, se nëse s’jemi të gjata, elegante dhe të bukura, nuk do të na dashurojë dhe honepsë kush.”⁵⁴

⁵³ - Katherine Bullock, op. cit., p.xiii.

⁵⁴ - <http://yvonneridley.org/analysis-and-opinion/how-i-came-to-love-the-veil>.

FAKTI I DYTË: KRITERI PROFETIK “MIRËSIA E INDIVIDIT VARET NGA MIRËSJELLJA E TIJ ME BASHKËSHORTEN”⁵⁵

Nuk ka dyshim, se gratë nga vetë natyra e tyre janë të dobëta apo të brishta, por kjo dobësi nuk bën pjesë tek dobësia e përbuzur, pasi kjo nga njëra anë është përtej vullnetit të tyre dhe nga ana tjetër është diçka e lavdëruar dhe e dëshiruar.

Sa i përket dobësisë së pavullnetshme të grave, ajo është dobësia strukturore fizike, për të cilën ato s'mund të bëjnë asgjë dhe as nuk mund të qortohen; ndërsa dobësia e lavdërueshme konsiston në delikatesën e zemrës dhe ndjesisë, përmes së cilës nënkuptohen emocionet e brishta dhe natyra e qetë, që padyshim është diçka për t'u admiruar tek gratë dhe sa më tepër të shtohet - por pa tepri - aq më shumë bëhet një karakteristikë më e sjellshme dhe më e hijshme ...

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) e vlerësonte këtë dobësi tek gratë dhe angazhohej, që ta imunizonte atë (gruan) prej dëmtimit fizik dhe moral. Mëshira dhe butësia e profetit Muhamed (Paqja qoftë mbi të) ndaj tyre shfaqet përmes një mori formash dhe qëndrimesh...

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) ka porositur vazhdimisht në favor të grave, duke u thënë shokëve të tij:

“Ju porosis që të jeni të mirësjellshëm ndaj grave”⁵⁶, këshillë kjo që përsëritet tekstualisht edhe në Haxhin e Lamtumirës, teksa Profeti

⁵⁵ - Materiali që vjen nga ky fragment deri në fundin e “Fakti i katërt: Dimensioni profetik i shpalosur në qëndrimet e tij ndaj femrave”, është shkëputur nga libri “Er-Rahmetu fi Hajati Er-Resul”, f. 91-100, me autor dr. Ragib Es-Sirxhani.

⁵⁶ - El-Bukhari 4890, Muslimi 1468 etj.

(Paqja qoftë mbi të) po u fliste mijëra të pranishmëve të Umetit (bashkësisë muslimane) të tij, duke qenë i bindur mbi rëndësinë strategjike të kësaj porosisë, deri në atë masë sa t'i dedikonte asaj një segment të veçantë të ligjëritimit të tij në atë ditë madhështore...

Në këtë ditë i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) ndër të tjera tha:

*“Ju porosis që të jeni të mirësjellshëm ndaj grave, pasi ato janë ‘robëresha’ tek ju.”*⁵⁷

Në këtë hadith, Profeti (Paqja qoftë mbi të) i përngjan gratë me robëreshat, ngaqë dihet se autoriteti dhe kujdestaria janë në dorën e burrit, vendimi për t'u divorcuar është po në dorën e tij, pa harruar këtu forcën e burrit dhe dobësinë e gruas, gjëra këto që e bëjnë gruan të mbetet në një situatë, ku s'mund të bëjë asnjë hile. Prandaj nëpërmjet këtyre fjalëve Profeti (Paqja qoftë mbi të) e zbut ndjesinë e burrit kundrejt dobësisë së saj.

Po në këtë kontekst, Profeti (Paqja qoftë mbi të) ka thënë:

*“Më i miri prej jush është ai, që është më i miri për bashkëshorten e tij dhe unë jam më i miri ndër ju për bashkëshorten time.”*⁵⁸

⁵⁷ - Et-Tirmidhi 1163, Ibn Maxhe 1851 dhe Amedi 20714; Albani thotë, se hadithi është hasen/i besueshëm.

⁵⁸ - Et-Tirmidhi 3895 që thotë, se transmetimi është sahih/i vërtetë; Ibn Maxhe 1977 etj.; Albani në “Sahihu El-Xhamia” 3314, ka thënë, se hadithi është sahih/i vërtetë.

FAKTI I TRETË: KRITERI PROFETIK “GRATË MERITOJNË BARAZI DHE KURRSESI ANTIPATI”

Përmes një artikulimi të mrekullueshëm retorik, i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) kristalizoj faktin, se gratë janë njësoj si burrat në vlerë dhe në pozitë, ndërsa të qenët e tyre gra nuk u pakëson atyre kurrsesi ndonjë gjë. Ai (Paqja qoftë mbi të) thotë: *“Faktikisht gratë janë simotrat (të barabartat) e burrave.”*⁵⁹ Ibn El-Ethiri thotë: *“Simotrat e burrave”* ka kuptimin: të njëjta dhe të barasvlershme me ta.”⁶⁰

Për më tepër, i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) i urdhëron muslimanët, që të mos ndjejnë antipati për gratë, qoftë edhe në rastet kur vërejnë tek ato (gratë) disa veti jo të dëshirueshme. Ai (Paqja qoftë mbi të) thotë: *“Besimtari të mos e urrejë besimtaren. Nëse urren një veti tek ajo, do të pëlqejë një veti tjetër të saj.”*⁶¹

Nuk ka dyshim, se Profeti (Paqja qoftë mbi të) e shpreh këtë koncept madhështor nën dritën e fjalës së Allahut të Madhëruar: **“Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duronit!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t’ju sjellë shumë të mira.”**⁶²

⁵⁹ - Et-Tirmidhi 113 dhe thotë, se hadithi është sahih/i vërtetë; Ebu Daudi 236 etj., Albani në “Sahihu El-Xhamia 1983 ka thënë, se hadithi është sahih/i vërtetë.

⁶⁰ - Aunu El-Meabudi v. 1, f. 275, me autor Muhamed Shemsulhak El-Adhimabadi.

⁶¹ - Muslimi 1469, El-Bejhaki në “Es-Sunen El-Kubra” 14504, etj.

⁶² - Kuran, En-Nisa: 19.

Aspekti që të bie më shumë në sy në lidhje me mëshirën, që i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) ushqente për gratë, është aspekti praktik, në jetën personale të tij (Paqja qoftë mbi të). Këto fjalë të mrekullueshme të Profetit (Paqja qoftë mbi të) nuk ishin thjesht «pilula» qetësuese për botën emocionale të grave, ose lajkatime joreale; në të vërtetë ato ishin fjalë, që zbatoheshin në jetën e përditshme - madje në çdo moment - në shtëpinë e Profetit (Paqja qoftë mbi të) dhe në shtëpitë e shokëve të tij fisnikë (Allahu qoftë i kënaqur me ta) ...

E sfidojmë botën mbarë, që të sjellë qoftë edhe një qëndrim apo rast të vetëm nga jeta e të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të), ku të ketë dëmtuar, lënduar apo rënduar një grua, qoftë prej bashkëshorteve të tij, qoftë prej grave të muslimanëve, madje qoftë edhe prej grave të idhujtarëve...

FAKTI I KATËRT: DIMENSIONI PROFETIK I SHPALOSUR NË QËNDRIMET E TIJ NDAJ FEMRËS

Në vijim do të paraqesim disa qëndrime brilante të të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të) ndaj femrës, të cilat mjaftojnë për të shpalosur qartë dimensionet e mëshirës dhe butësisë, që profeti Muhamed (Paqja qoftë mbi të) ushqente ndaj tyre.

Qëndrimi mëshirues dhe i butë i Profetit (Paqja qoftë mbi të) me bashkëshorten

Kur Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të) kërkoi leje për të hyrë tek i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të), dëgjoi Aishen (vajzën e tij) teksa ngrinte zërin. Pasi hyri brenda, ai (Ebu Bekri) u orvat ta godiste atë (Aishen) duke i thënë: “A po të shoh t’ia

ngresh zërin të Dërguarit të Allahut?!” Profeti (Paqja qoftë mbi të) e pengoi nga kjo gjë dhe Ebu Bekri doli i zemëruar [me Aishen]. Pasi Ebu Bekri doli, Profeti (Paqja qoftë mbi të) i tha [Aishes]: *“A e pe, se si të shpëtova prej tij (Ebu Bekrit)?”* Pas disa ditësh, Ebu Bekri shkoi tek shtëpia e Profetit (Paqja qoftë mbi të) dhe i kërkoi leje të hynte. Kur hyri, pa se ata të dy [Profeti dhe Aishja] ishin pajtuar. Atëherë ai tha: “Më përfshini edhe mua në paqëtimin tuaj, siç më përfshitë në konfliktin tuaj.” Profeti (Paqja qoftë mbi të) tha: *“Ashtu po bëjmë, ashtu.”*⁶³

Mëshira dhe butësia e Profetit (Paqja qoftë mbi të) ndaj rastit në fjalë ishte më e madhe se ajo (mëshira) e babait. Babai i Aishes (Ebu Bekri) deshi ta ndëshkonte atë për gabimin e bërë, ndërsa i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të), për shkak se ushqente mëshirë për Aishen (Allahu qoftë i kënaqur me të), e pengoi babain e saj - Ebu Bekrin (Allahu qoftë i kënaqur me të) -, që ta ndëshkonte atë.

Ndodhi njëherë, që bashkëshortja e Profetit (Paqja qoftë mbi të) gaboi fort dhe sikletshëm në sytë e njerëzve, por pavarësisht kësaj, falë mëshirës dhe butësisë së tij, ai (Paqja qoftë mbi të) e arsyetoi qëndrimin e saj, e mëshiroi dobësinë e saj, e justifikoi xhelozinë e saj dhe nuk u irritua e nuk u rrëmbye, por toleroi dhe fali. Pikërisht në këtë kontekst, Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton, se i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) gjendej (me disa sahabë) tek njëra prej nënave të besimtarëve (tek një prej bashkëshorteve të tij) dhe njëra nga bashkëshortet e tjera dërgoi ushqim tek ata. Ajo (bashkëshortja ku gjendeshin) e goditi dorën e atij që solli ushqimin dhe ena me ushqim u rrëzua dhe u thye. Profeti (Paqja

⁶³ - Ebu Daudi 4999, Ahmedi 18418 etj.; Shuajb El-Arnauti thotë, se hadithi është sahih/i vërtetë, sipas kritereve të Muslimit.

qoftë mbi të) i mori dy copat, i bashkoi me njëra - tjetrën dhe në to e grumbulloi ushqimin, duke thënë: “*U bë zheloze nëna juaj, hani!*” Ata hëngrën dhe ai (Paqja qoftë mbi të) priti, derisa ajo (bashkëshortja ku gjendeshin) solli një enë të shtëpisë së saj. Enën e saktë [Profeti (Paqja qoftë mbi të)] ia dha atij që solli ushqimin, ndërsa enën e thyer e la në shtëpinë e asaj që e theu.”⁶⁴

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) mbajti qëndrim të matur, e mblodhi ushqimin, i ftoi miqtë e tij të hanë dhe zemërimin e bashkëshortes së vet e interpretoi si pasojë të xhelozisë, duke mos harruar ta ngrejë lart vlerën e saj, përmes thënies: “*U bë zheloze nëna juaj*”, pra nëna e besimtarëve!!

Sa mëshirë të mrekullueshme kishte në zemrën e Muhamedit (Paqja qoftë mbi të)!

Qëndrimi mëshirues dhe i butë i Profetit (Paqja qoftë mbi të) ndaj vejushave

Nuk ka dyshim, se mëshira dhe butësia e Profetit (Paqja qoftë mbi të) për jetimët ishte e madhe dhe e fuqishme dhe po në këtë linjë vjen edhe mëshira dhe butësia e tij e madhe dhe besnike për vejushat...

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) e ka ngritur në pedestal vlerën e atij që përkujdeset për çështjet e gruas së ve, madje e ka ngritur në atë nivel, ku nuk i shkon mendja askujt. Ai (Paqja qoftë mbi të) ka thënë: “*Kush rend pas [halleve të] vejushës dhe të vobektit, është si ai që përpiqet [bën përpjekje të armatosur] në Rrugë të Allahut,*

⁶⁴ - El-Buhari 2349, En-Nesai 3955 (teksti i hadithit është sipas transmetimit të En-Nesaiut) etj.

apo si ai që falet përgjatë natës dhe agjëron gjatë ditës.”⁶⁵

Çfarë vlere dhe nderimi!!

I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) ishte njeriu, i cili nxitonte më shumë se çdokush tjetër, për ta praktikuar atë që thoshte. Në këtë kontekst Abdullah Ibn Ebi Eufe, transmeton: “Profeti (Paqja qoftë mbi të) e vlerësonte dhe nuk e përbuzte ecjen me vejushën dhe të vobektin, që të shkonte e t’ua kryente atyre nevojën që kishin.”⁶⁶

Qëndrimi mëshirues dhe i butë i Profetit (Paqja qoftë mbi të) ndaj skllaveve

Më e mahnitshme se kjo, është mëshira e tij (Paqja qoftë mbi të) për skllaven. Në këtë kontekst, Enes Ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton: “Është e vërtetë, që ndonjëra prej skllaveve të banorëve të Medinës e merrte përdore të Dërguarin e Allahut (Paqja qoftë mbi të) dhe shkonte me të ku donte!”⁶⁷ Ibn Haxheri e komenton këtë me fjalët: “Të shprehurit me ‘e merrte përdore’ tregon sjelljen më të arrirë, pra edhe kur skllaves i nevojitej diçka jashtë Medinës, ajo i kërkonte atij (Paqja qoftë mbi të) ta ndihmonte. E gjitha kjo tregon për modestinë maksimale të Profetit (Paqja qoftë mbi të) dhe distancimin e tij të skajshëm nga të gjitha llojet e mendjemadhësisë.”⁶⁸

⁶⁵ - El-Buhari 5028, Muslimi 2982 etj.

⁶⁶ - En-Nesai 1414, Ed-Darimi 74 etj.; Albani ka thënë, se hadithi është sahih/i vërtetë.

⁶⁷ - El-Buhari (me tekstin në fjalë) 5724, Ebu Daudi 4818 dhe Ibn Maxhe 4177.

⁶⁸ - Fet’hu El-Bari v. 1. F. 490, me autor Ibn Haxher.

Natyrshëm mbetet të shtrohet pyetja retorike:

“A kanë dëgjuar banorët e tokës, që një kryetar shteti apo komandant suprem i një kombi, të shkojë në vende të ndryshme dhe ai vetë t’ia kryejë gjërat që i nevojiten një gruaje të thjeshtë, që është veç një shërbëtore, apo akoma më mrekullueshëm një gruaje që është veç një skllave, e cila nuk ka në dorë asgjë prej çështjes së vet”?!

Këto sjellje dhe virtyte të të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të), përbëjnë argumentin më të arrirë mbi profetësinë e tij, pasi këto karaktere dhe morale prestigjioze nuk mund të rrjedhin përveçse nga një profet i Zotit.

Të vërtetën ka thënë Allahu i Lartësuar për të Dërguarin e Tij, Muhamedin (Paqja qoftë mbi të): **“Nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), përveçse mëshirë për botët.”**⁶⁹

⁶⁹ - Kuran, El-Enbija: 107.

REALITETI I DYTË:

Domosdoshmëria e hixhabit në
logjikën e shëndoshë
Domosdoshmëria e hixhabit është
brenda kornizave të logjikës
së shëndoshë



SË PARI:

Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave të natyrës fiziologjike humane

**FAKTI I PARË: ISLAMI E NJEH TËRHEQJEN FIZIOLOGJIKE
MES DY GJINIVE TË KUNDËRTA NJERËZORE**

Krijuesi i botëve e rendit dashurinë për gruan në rendin e parë të pasioneve më të fuqishme, për të cilat është i prirur mashkulli. Në lidhje me këtë, Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin fisnik: **“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.”**⁷⁰

Krijuesi jo vetëm e ka bërë të ditur këtë realitet, por për më tepër Ai e ka skalitur dashurinë e dëlirë për botën femërore në zemrën e profetit të Tij të fundit, Muhamedit (Paqja qoftë mbi të), i cili thotë për këtë fakt: *“Nga dynjaja juaj, më janë bërë të dashura gratë dhe*

⁷⁰ - Kuran, Ali Imran: 14.

parfumi, ndërsa kënaqësi e syrit më është bërë namazi.”⁷¹

Pra Islami e vlerëson lart femrën dhe pikërisht për t’i ruajtur e rritur vlerat e saj, ai e blndon atë me fortifikata që e mbrojnë nga shpërdorimet e abuzuesve, me ligje hyjnore gjithëpërfshirëse që angazhojnë si burrin ashtu edhe gruan: pra burri duhet të ruajë të pacënueshëm intimitetin e tij, qoftë edhe nga shikimet apo prekjet e gjinisë së kundërt të ndaluar, ndërsa gruaja duhet ta ndihmojë burrin e saj, që t’ia dedikojë vetëm asaj sensualitetin e tij dhe gratë e arrijnë këtë gjë, duke u mbuluar nga sytë epshorë të meshkujve të huaj...

Ky vlerësim dhe garantim islam i demaskon falsifikimet që komercialistët perëndimorë (dhe më gjerë) i kanë bërë “bukurisë” dhe “lirisë” së femrës - që dëmton thelbin e saj si qenie - duke e shndërruar këtë femër në mjet reklamimi të kompanive kozmetike dhe në robëreshë të pseudo-burrave për të cilët grua e bëshme konsiderohet vetëm ajo që ka mish të njomë dhe ngjyra kozmetike (make up) tunduese, ose thënë ndryshe: gruaja shndërrohet në karrem të grepave të pamëshirshëm materialisto-egoistë. Falsiteti i pseudointeresimit perëndimor për femrën, demaskohet qartë nga prononcimi i urtë dhe i qëlluar: “Nëse dëshiron të vëresh nderimin e vërtetë të femrës në Perëndim, shikoje atë tek sjellja perëndimore ndaj nënës, bashkëshortes, bijës, motrës apo edhe ndaj femrës së plakur në përgjithësi...”

⁷¹ - Ahmedî 12293, 12294; En-Nesai v. 7, f. 61-62; El-Hakim v. 2 f. 160 (i cili thotë se ky transmetim është sahih/i vërtetë) dhe Ed-Dijau në përpilimin “El-Mukhtara” 1737 (i cili thotë gjithashtu, se ky transmetim është sahih/i vërtetë). Këtë transmetim e klasifikon si transmetim të fortë edhe Edh-Dhehebi në përpilimin “El-Mijzan” v. 2, f. 177, ndërsa Ibn Haxheri në përpilimin “Et-Telkhis” v.3, f. 116, e konsideron këtë transmetim të gradës hasen/i besueshëm.

**FAKTI I DYTË: EPSHI NJERËZOR ËSHTË ASNJANËS DHE SI
I TILLË AI DUHET KANALIZUAR**

Epshi human është asnjanes dhe ti si njeri, falë vullnetit të lirë që posedon, mund ta përdorësh atë për t'u ngjitur në piedestalet humane, ose për t'u gremisur në fundërrinat e njerëzimit.

Realitetin asnjanes (neutral) të epshit, e sqaron shumë bukur dr. Nabulsi në ilustrimin e tij, në të cilin e përngjason epshin me karburantin e lëngët të automjetit. Dr. Nabulsi thotë: “Nëse lëngu i karburantit vendoset në depozitën e saktë, rrjedh në tubat ekzaktë dhe ndizet në kohën dhe vendin e duhur, në këtë rast prej këtij lëngu kryhet lëvizje e dobishme. Mirëpo nëse ky lëng (karburant) derdhet mbi automjet dhe i vihet flaka, ai e djeg automjetin me gjithë çka brenda tij.

Pra ky karburant i lëngët, ashtu siç është fuqi e dobishme dhe e shkëlqyeshme lëvizëse, po ashtu është edhe fuqi shkatërruese e dërrmuese. I tillë është pikërisht edhe epshi. Besimi im kategorik është, se epshet në vetvete janë asnjanes dhe me to mund të ngjitesh për në pedestal, ose të biesh në honet gremisëse të fundërrinës njerëzore.

Si shembulli për rastin e parë (të dobishëm), po japim një person, i cili martohet me një grua të mirë, shikimi i saj i dhuron lumturi, ajo i bindet nëse ai e urdhëron, ia ruan nderin dhe familjen kur ai mungon dhe bën me të djem të mbarë e vajza, të cilët martohen me të rinj besimtarë. Një familje e tillë është e shkëlqyeshme, me nipa dhe stërnipa, mbesa e stërmbesa të mbarë. Edukimi i brezave të saj është me nivel të lartë dhe ata janë individë të dëlirë në shoqëri. Paraardhësi më i vjetër i këtyre gjeneratave gëzon një pozitë shumë

të shquar... dhe zanafilla e gjithë kësaj është raporti seksual, apo jo?!

Si shembulli për rastin e dytë (të dëmshëm) po japim një njeri tjetër, i cili ka hapur një klub nate, ku kryhen faje dhe mëkate, ku ata që shkojnë aty, mund të bien në imoralitet dhe haram (vepra të paligjshme) e kështu me radhë. Kështu ky vend është qendër e shthurjes morale ... dhe zanafilla e saj është sërish raporti seksual.

Pra epshi është asnjans dhe me të mund të ngjitesh në piedestalet humane, ose të gremisesh në fundërrinat njerëzore dhe në të dy rastet epshi është po i njëjti.”⁷²

FAKTI I TRETË: NJË EPSH I PAKONTROLLUAR ÇON NË RRËNIMIN E LUMTURISË

Është fakt, se pasioni apo sensualiteti është fuqia lëvizëse e njeriut, e cila në origjinë është asnjansë dhe nëse përdoret siç duhet, me lejen e Zotit e ngjit njeriun në pedestal, por nëse keqpërdoret, e gremis atë në humnerë...

Ka ndryshim të madh mes instiktit të njeriut dhe karakterit të tij: i pari është tipar i përgjithshëm i botës shtazore, kurse i dyti është një veçori humane, që e mundëson njeriun të arrijë tek virtyti i lartë. Rëndësia e virtytit të lartë mund të spikatet më së miri tek besimtari musliman, se si ai jeton i balancuar mes drejtësisë dhe vetëkontrollit dhe se si përmbushjen e epshit të tij muslimani e dëlirëson nëpër filtrat hyjnorë të: udhëzimit të argumentuar, disiplinimit të përshkallëzuar dhe virtytit të përparuar ...

⁷² - Shih: <http://nabulsi.com/blue/ar/print.php?art=1400> (me ndërhyrje të vogla). Lënda në vijim e faktit të dytë dhe të tretë, referohet tek burimi në fjalë i kësaj fusnote (me ndërhyrje të vogla.)

Ka dallim të madh mes lumturisë dhe sensualitetit (epshit): sensualiteti është shqisur, kënaqet përmes të mirave materiale si ushqimi, veshja, raporti seksual, shtëpia, pasuria e katandia, - si për mashkullin, ashtu edhe për femrën - dhe buron nga jashtë unit njerëzor...

Krijuesi i Madhëruar, për një urtësi shumë të madhe, deshi që sensualiteti në këtë botë të mos ketë furnizim të vazhdueshëm, por furnizimi i tij të jetë i mangët. Çdo kënaqësi sensuale e ka një vlim dhe pasohet nga rënia, bëhet diçka e zakonshme dhe në fund e humbet komplet "lustrën" e saj... Kështu njerëzit që arrijnë të kenë sukses në një objektiv të kësaj bote, me ta arritur këtë sukses, ndjejnë një boshllëk shumë të madh në shpirtin e tyre, sepse boshllëkun e shpirtit nuk e mbush dot as paraja, as pozita dhe as stolitë e kësaj dunjaje...

Kjo ndodh, sepse njeriu është krijuar për njohjen e vazhdueshme të përhershmerisë së Allahut të Madhëruar, ndaj dhe shpirti njerëzor për nga natyra e tij aspiron pambarimisht, ndërsa rreziku më kërcënues për shpirtin njerëzor qëndron pikërisht tek aspiratat dritëshkurtra, falsiteti i të cilave demaskohet me boshllëkun irritues shpirtëror, që e pushton personin, sapo t'i arrijë këto pseudo-aspirata...

FAKTI I KATËRT: BOTA SENSUALE/SEKSUALE DHE ROLI I SAJ I PATJETËRSUESHËM MES DY GJINIVE TË KUNDËRTA NJERËZORE

Instikti seksual është një prej sekreteve, që Zoti vendosi tek burrat dhe gratë për urtësi të shumta, prej të cilave është edhe vijimësia e llojit njerëzor...

Askush nuk mund ta mohojë ekzistencën e këtij instikti, prandaj është marrëzi të kërkosësh vetëpërmbytje dhe reagim të natyrshëm nga meshkujt, teksa atyre u ekspozohen pareshtur panorama lakuriqësie dhe zhveshjeje, duke anashkaluar ndikimin e fuqishëm të instiktit seksual...

Tërheqja mes burrave dhe grave është e natyrshme/instiktive dhe do të mbetet e tillë, sepse ajo lëviz në dejet e dy palëve, duke rrezatuar tek seksi i kundërt tendenca dhe instinkte, që përthithen automatikisht dhe vënë në lëvizje gjëndrat hormonale, të cilat prodhojnë shfrenueshëm hormone në gjak, që ndikojnë drejtpërdrejt në tru dhe në sistemin nervor...

Karakteristikat femërore spikasin tek tërësia strukturore e trupit të saj, tek paraqitja, sjelljet, mendimet dhe tendencat e saj; ndërsa karakteristikat mashkullore spikasin tek trupi, paraqitja, zëri, veprimet dhe prirjet e tij ...

Ashtu siç erotika sensuale/seksuale e vendosur në unin njerëzor është prej sekreteve dhe urtësive të Zotit, po ashtu është edhe raporti seksual, që përbën ngacmuesin dhe shënjestrimin më të fuqishëm të mendjes, unit dhe shpirtit njerëzor...

Bota e pasioneve dhe sensualitetit është pa dyshim një nga mirësitë më të mëdha të Krijuesit, me të cilën Ai e pajisi krijesën e Tij (njeriun), duke e sistemuar dhe balancuar atë me norma e dispozita ligjore hyjnore...

Vetëm kur bota e pasionit u shfrenua, u bëmë dëshmitarë të apartamenteve pa shtëpi, shtëpive pa bashkëshortë, fëmijëve pa prindër, bashkëjetuesve të pamartuar, perversëve sensualisht të devijuar etj...

SË DYTË:

Domosdoshmëria e hixhabit është brenda kornizave të mirëqenies sociale

FAKTI I PARË: ZHVESHJA NGA HIXHABI PËRBËN ZBËRTHIM TË FAMILJES DHE MIRËQENIES SOCIALE

Nuk dua të akuzoj askënd në thelbin e zemrës së tij, por dua të përmend fakte që bëjnë “muuu”, - siç thotë populli...

Përfytyroni sa të lumtur do të ishin ato çifte, që do të vepronin vetëm sipas udhëzimeve islame, pra nëse tërësia e joshjeve femërore të gruas do të aplikohet vetëm brenda ambienteve private bashkëshortore, ku pa dyshim vendin kryesor e zë shtëpia dhe sidomos dhoma e gjumit...

Mirëpo në vend që femra të përpiket të jetë sa më joshëse në sjellje dhe veshje brenda në shtëpi me bashkëshortin e saj, ndërsa kur del jashtë - në vende ku dominojnë meshkujt (të cilët nuk ka dyshim se do mendojnë me epsh për të) - të vishet dhe të sillet sa më serioze, për fat të keq ajo që ndodh është e kundërta... Teksa gruaja qëndron me minuta të tëra para pasqyrës, parfumeve dhe kozmetikës, duke u përgatitur për të dalë në rrugë të madhe, ajo

ia mbyll shpejt e shpejt gojën burrit të saj me një togfjalësh, që e thotë gjithmonë me shkujdesje në situata të tilla: “Për ty jam bërë kështu”... a thua se burri i shkretë ka “pasqyra anësore”...

Teksa faktikisht (siç shprehet dr. Bilal Filips) mendja e pashpëlarë, pavarësisht asaj që realisht synon femra e shkretë, e degraduar në këtë gjendje, e pranon se ajo femër që del në rrugë të madhe më shumë e zhveshur sesa e veshur, lyer e zhgërryer me parfumin dhe kozmetikën e saj joshëse, vetëm sa po u thotë meshkujve të huaj: “I am available/Jam e gatshme” ...

Sarkazma e Ahmed Didatit është me vend, kur thotë se edhe një burrë plak nuk do të ndihej rehat, kur sytë t’i binin mbi këto femra “të veshura por të zhveshura”. Në një rast tjetër, dr. Didati ia çjerr ashikare maskën pseudokulturës perëndimore, duke thënë se trendi i saj në fakt është: “shndërrimi i gruas në makineri seksi dhe pune” dhe arritja e këtij objekti arrihet më së miri, duke e bërë gruan elektron të lirë - të shkëputur nga graviteti i institucionit të familjes -, duke e “çliruar” atë nga manteli i trupit (veshja e përshtatshme) dhe si rezultat i kësaj edhe nga manteli i turpit dhe dinjitetit...

Gjuha e aktualitetit e shpreh në mënyrë shumë të qëlluar realitetin therës të shumë grave të ditëve të sotme, të cilat nuk e njohin sensin e veshjes: “Gruaja e gjorë qëndron gjithë ditën në publik, më shumë zhveshur sesa veshur, ndërsa në darkë shkon e futet në shtratin e burrit të saj me pizhame”...

FAKTI I DYTË: ZHVESHJA SHPIE NË ANARKI, SHTAZËRI DHE ZVETËNIM E KURRSESI NË QYTETËRIM

Zhveshja shpie në anarki (çrregullim social), shtazëri, dhe zvetënim e kurrsesi në qytetërim. Pseudoliria që lejon çdo gjë dhe refuzon t’i vendosë kufi veprimeve të njeriut, në fakt është anarki

dhe shtazëri, pasi kësioj njeriu ia lëshon frerët instiktit të tij dhe nuk e kanalizon sensualizmin e tij me filtrin e të mirës (pozitives) apo të keqes (negatives)... Trampolina e kësaj anarkie shtazarake është filozofia materialiste blasfemike, se “njeriu jeton vetëm një jetë, ndërsa më pas bëhet dhé varri e asgjësohet”, pra - sipas mohuesve të Shpalljes së Zotit - njeriun pas vdekjes nuk e pret as gjykim, as shpërblim dhe as ndëshkim...

Mirëpo kjo gjë bie ndesh kryekëput me botëkuptimin aksiomatik hyjnor islam mbi ekzistencën e qenies njerëzore, i cili dekreton se “njeriut iu mundësua të jetë mëkëmbës në tokë, në mënyrë që ta gjallërojë tokën me ligjet e Krijuesit të gjithësisë, kundrejt shpërblimit të amshueshëm”. Botëkuptimi islam sqaron me argumente, se kjo botë është rrugë dhe jo vendbanim, është testim dhe jo rehati, është bota e punës dhe jo e shpërblimit, është parcelë të mbjellash, të cilat korren në amshim, se në këtë botë sprovohet nefsi (uni), zemra, goja dhe gjymtyrët njerëzore, se sa do t'i zbatojë e jetësojë udhëzimet autentike hyjnore, ndërsa pas vdekjes çdo njeri do të ringjallet sërish, për t'u gjykuar para drejtësisë supreme hyjnore, ku do të shpërblehet me Xhenet (Parajsë), ose do të ndëshkohet me Xhehenem (Ferr), në varësi të punëve që ka kryer (jetësimit/zbatimit të udhëzimeve autentike hyjnore)...

Nëse zhveshja do të përbënte vlerë dhe qytetërim, atëherë kafshët do të ishin gjallesat më të qytetëruara... Po sa e qytetëruar mund të jetë një botë, ku femra është thujse e telekomanduar në çështjen e saj më të rëndësishme, atë të veshjes/zhveshjes së saj; sa e qytetëruar mund të jetë një botë, ku hijeshitë femërore janë zhvlerësuar aq shumë, saqë huret femërore më intime shfaqen me detaje në rrugë të madhe?!

Një stilist i famshëm francez e vulos faktin e mësipërm me thënien e tij, sa të poshtër po aq edhe reale: “Me një të rënë të lapsit, unë

diktoj sesi do të vishen/zhvishen nesër femrat e Francës...”, dhe natyrisht së andejmi epidemia merr botën mbarë. Kjo nuk është gjë tjetër, përveçse shpëlarje e trurit në masë...

A nuk e keni parë mënyrën skandaloze të veshjes së kukullës Barbi - me të cilën janë lidhur dhe luajnë aq shumë vogëlushet tona - qoftë në filmat me kartona, qoftë në dyqane; për të mos bërë fjalë për personazhet e tjera kryesore të filmave me apo pa kartona, që i shikojnë vogëlushet dhe adoleshentet tona?! Kjo është thjesht shpëlarje truri në masë...

Më ironik dhe paradoksal është realiteti perëndimor: ku femra është “çliruar” nga rrobat e saj dhe po tund “triumfuese” rripat e fundit të mbetura në trupin e saj, ndërsa në të njëjtën kohë si për çudi i mëshohet fuqishëm ligjeve dhe masave të rrepta penale kundër përdhunimeve... Mirëpo siç thotë populli: “baruti dhe zjarri nuk mund të rrinë bashkë” dhe në fakt “baruti” (imoraliteti) ka plasur keqas në Perëndim, ku jo vetëm përdhunimet fizike por edhe ato morale të femrës kanë marrë tatëpjetën...

FAKTI I TRETË: HIXHABI KONSOLIDON ETIKËN E LARTË DHE MODESTINË

Gruaja muslimane e di mjaft mirë, se krahas veshjes së trupit të saj fizik, ekziston edhe një “veshje” tjetër, që Allahu i Madhëruar e ka quajtur “devotshmëria para Allahut”; dhe nëse kjo devotshmëri do ta “veshë hijshëm” zemrën e gruas muslimane, atëherë me lejen e Allahut, muslimanja do t’i përballojë edhe sfidat e veshjes së trupit dhe do ta zbatojë me dëshirë urdhrin e Allahut të Madhëruar për veshjen e hixhabit, e brumosur me bindjen se në këtë urdhër gjendet mirësia e saj në dunja dhe Ahiret...

Hixhabi (mbulesa fetare e gruas) nuk është thjesht një copë tekstili, që femra e vendos mbi kokën e saj, por përtej kësaj ai është metodologji e përpiktë komunikimi, raportesh dhe ndjesish, ashtu siç është edhe sistem besimi, sjelljeje e ndijimi, që ligji hyjnor islam e ka përsosur më së miri...

Modestia në veshje është urdhër parimor i Islamit, ndërsa ekspozimi i formave të trupit nëpërmjet veshjeve të ngushta apo transparente, ose veshjeve që nxjerrin në pah lakuriqësinë, në kandin e virtytit përbën padyshim antonimin e modestisë. Në këtë çështje, burri dhe grua janë të barabartë, prandaj sipas mendimeve të mirëargumentuara të shumë dijetarëve muslimanë, rekomandohet që edhe burrat të veshin xhelabije (këmishë e gjatë që shkon deri poshtë gjurit), ose së paku pantallona të gjera, jo të tejdukshme, që nuk i nxjerrin në pah format e trupit. Jo vetëm kaq, por edhe mbulimi i kokës me shaminë karakteristike burrërore të kokës përbën një traditë të bukur të veshjes modeste profetike. Në një shoqëri të tillë muslimane, burrat dhe gratë janë të veshur afërsisht njësoj. Modestia në veshje ka qenë e pranishme edhe tek shqiptarët, në jug me fustanella dhe në veri me tirqe....

Kohë më vonë burrat filluan të zbuloheshin gjithnjë e më shumë, kurse femrat mbetën të veshura siç duhet në jetën publike, ndërsa së fundmi (në kohët e ashtuquajtura moderne) kemi arritur në ekstrem, ku femra po e zbulon thujtë tërësish trupin e saj, ndërsa burri po mbërthehet deri në fytyrë dhe nuk guxon të zbulohet as sa gjysma e femrës, sepse mund të etiketohet si njeri i marrë nga “kritikët e modës”...

Dëlirësia dhe modestia nuk gjenden vetëm në zemër, por gjenden në zemër dhe në trup. Nuk mund të ketë zemër të dëlirë dhe të pastër, nëse gjymtyrët bëjnë punë të pista. Muslimanja e di mirë, se imoraliteti nuk bën vetëm organi gjenital, por në këtë gjynah bie edhe syri që shikon në haram, prandaj ajo nuk e lejon kurrsesi veten e saj, që të jetë instrument përmes të cilit burrat e huaj të bien në imoralitetin e syrit...

Dëlirësia është bimë madhështore, që rrënjët i ka në zemër dhe frutet i çelin tek gjymtyrët. Përmirësimi i unit është kusht për përmirësimin e gjymtyrëve, e nga ana tjetër përmirësimi i gjymtyrëve çon në neutralizimin e ngacmuesve, që nxisin raporte të paligjshme dhe dhunim të të drejtave mes dy gjinive të kundërta, ku me siguri në listën e këtyre ngacmuesve/nxitësve një vend që nuk duhet neglizhuar zë edhe zhveshja apo veshja e femrës me rroba të ngushta.

Për sa më sipër, kujdes mund të bëjë vetëm ai, i cili fortifikon dhe ruan unin e tij nga gjeneruesit më të rrezikshëm të mëkateve dhe sprovave, gjë që mund të arrihet vetëm duke sjellë vazhdimisht ndërmend mbikëqyrjen e Allahut të Madhëruar - të Cilit nuk i shpëton asgjë prej akteve tona, që i bëjmë haptas apo fshehtas njerëzve - dhe duke e përkujtuar vazhdimisht unin tonë me premtimin e Shpalljes Hyjnore: shpërblim për mirësinë dhe dëlirësinë, si dhe ndëshkim për ligësinë dhe shthurjen...

FAKTI I KATËRT: ZHVESHTJA GRADUALE E FEMRËS ËSHTË ANTONIM I MIRËQENIES SOCIALE TË SAJ DHE SHOQËRISË KU AJO JETON

Është fakt, se burri është shumë i ndjeshëm kundrejt ngacmimeve pamore dhe se instikti epshor i tij nuk resht së kërkuari forma dhe burime të reja për të përmbushur epshin e tij; ndryshe nga gruaja që ndikohet më shumë nga sjelljet sesa nga paraqitja fizike, duke qenë se temperamenti i saj është i prirur tek jeta emocionale e stabilizuar dhe e pandryshueshme, me trajtë të qëndrueshme raportesh. Sa u tha më sipër, është bazuar në studimet shkencore të dy sondazheve të bëra në Amerikë:

sipas një sondazhi të vitit 1994, u konstatua se burrat në Amerikë - ku dominon mendësia, se i pamartuari nuk ka asnjë pengesë/ problem të ketë raporte seksuale (jashtë kurorës martesore) - mendonin të kishin raporte seksuale me gjashtë gra gjatë atij viti

dhe mendonin të kishin raporte me tetë gra për dy vitet në vijim, ndërkohë që gratë (në të njëjtën intervistë dhe në të njëjtat vende) mendonin të kishin raporte seksuale me një burrë të vetëm gjatë atij viti dhe mendonin të vazhdonin marrëdhënien po me të njëjtin burrë edhe për vitin në vijim;

sipas një sondazhi të vitit 1997, grave të intervistuar u shfaqeshin revista me pamje provokative seksuale burrash dhe 4/5 (80%) e grave të intervistuar u shprehën, se pamjet e revistave në fjalë nuk përbënin ngacmim seksual për to ...⁷³

Sondazhet flasin qartë, se zhveshja graduale e femrës në vendet ku u promovua një gjë e tillë, me pretendimin e arritjes së mirëqenies së saj dhe të shoqërisë, vetëm sa nxiti më tepër përdhunimin dhe përçmimin e femrës.

“Të paktën $\frac{2}{3}$ e grave i janë ekspozuar gjatë jetës së tyre tablove të ndryshme të dhunimit shtëpiak, dukuri që ka pasur impaktin e vet vjetor tek katër milion gra në Gjermani dhe katër milion bashkëshorte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.”⁷⁴

Të dhënat lidhur me përdhunimet, ngacmimet seksuale dhe krimet e tjera morale që bëhen kundër femrave në Perëndim (Amerikë, Evropë etj.), të cilët sipas pretendimit të tyre i kanë dhënë një rol tejet të rëndësishëm lirisë së individit, tregojnë se situata ka dalë jashtë kontrollit dhe shfrenimi moral ka arritur kulmin. Më konkretisht në librin “Krimi në Amerikë” lexojmë, se krimi i përdhunimit seksual të dhunshëm që ndodh në Amerikë, kap shifrën 1 person për çdo 6 minuta, teksa të dhënat më të reja tregojnë, se ky krim është rritur edhe më shumë...

⁷³ - Are pictures of naked men sexy?: New York Post woman-on-the-street interview, December 29, 1997 (Quoted by, Wendy Shalit, op. cit., p.116 dhe Wendy Shalit, op. cit., pp. 90-91.

⁷⁴ - Frederiko Mayer, “New World”, f. 137.

Përqindja më e lartë e shthurjes, shfrenimit dhe perversitetit seksual dhe në të njëjtën kohë humbjes së nderit dhe ngatërimit të gjenealogjisë/prejardhjes familjare, është e lidhur ngushtë me daljen e femrës në publik të pispillosur mes veshjes dhe zhveshjes. Kjo përqindje është në përpjestim të drejtë me daljen e gruas në publik me një pamje të zhveshur nga çdo fisnikëri dhe vlerë... Përqindja më e lartë e sëmundjeve seksuale si AIDS (sida) etj. gjendet në vendet e shfrenuara, ku pseudoliria e femrës ka dalë jashtë çdo kontrolli, duke i shtuar kësaj edhe sëmundjet e ngërçet shpirtërore, që i kanë bërë shumë të rinj e të reja të këtyre shteteve të “strehohen” tek vetëvrasja...

Shifrat tregojnë, se mirëqenia femërore në botën që injoron hixhabin, mbetet një mirazh

Sa në të vërtetë arriten modelet perëndimore të realizojnë fisnikërimin e gruas, sa e çmuan vlerën e saj dhe sa e përmbushën lumturimin e saj?

Le të përgjigjemi me gjuhën e shifrave, të cilat i sjell tek ne një shërbim zyrtar amerikan përmes sondazhit të bërë prej tij në vitin 2007, lidhur me profesionet që kanë bërë gratë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 2007. Sipas këtij sondazhi:

96.7 % e punonjësve të sekretarisë dhe shërbimeve administrative janë gra!

75.6 % e merceollogëve (shitësve) janë gra!

74 % e kamarierëve janë gra!

93 % e recepsionistëve janë gra!

68.5 % e punonjësve të shërbimit ndaj klientëve janë gra!

89.2 % e shërbyesve dhe punëtorëve të pastrimit janë gra!

92.9 % e punonjësve të parukerive dhe kozmetikës janë gra!⁷⁵

⁷⁵ - <http://dol.gov/wb/factsheets/20lead2007.htm>.

SË TRETË:

**Domosdoshmëria e hixhabit është brenda
kornizave të logjikës së shëndoshë**

Domosdoshmëria e hixhabit (veshjes/mbulesës fetare të gruas) është brenda kornizave të logjikës së shëndoshë, mbështetur në faktet në vijim:

FAKTI I PARË: ZHVESHJA NGA HIXHABI ËSHTË ZHVLERËSIM

Çudi me burrat e sotëm, gratë e të cilëve janë zhvlerësuar aq shumë, saqë për detajet e botës së tyre trupore dhe sensuale mund të marrësh një lum me materiale vetëm me një “klikim” të syrit në rrugë, apo të gishtit në “rrugën e madhe (internet)”, kurse një depërtim tek llogaria bankare e këtyre “burrave” është një “mission impossible”, a thua se gratë e tyre kanë vërtet më pak vlerë se paratë e tyre?!

Në shoqëritë perëndimore që mbrojnë me fanatizëm fenomenin e zbulimit pa kufi të trupit të femrës, duke sulmuar haptazi institucionin e martesës me përkufizime të mbrapshta të tipit “Martesa është

dhunim legal”⁷⁶, zhvlerësimi i femrës po rritet në shifra gjithnjë e më alarmante, falë çlirimit ligjor të burrave nga përgjegjësitë e tyre bashkëshortore, prindërore dhe familjare, sidomos pas përhapjes në masë të fenomenit të ashtuquajtur “bashkëjetesë”, i cili është në fakt argumenti më i fortë i mosbesimit të këtyre çifteve për të jetur dhe formuar familje bashkë. Kjo gjë ka krijuar një vatrë pjellore për përhapjen epidemike të shthurjes morale, shfrenimit seksual, perversitetit, tradhëtisë bashkëshortore, shpërbërjes së familjes, divorceve, sëmundjeve të pashërueshme seksuale dhe atyre mendore...

FAKTI I DYTË: SPEKULIMET ME HIXHABIN BËHEN PËR INTERESA TË NGUSHTA NGA NJERËZ JOPARIMORË

A nuk është për t’u çuditur me pseudo-kërkuesit e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe femrës në veçanti, të cilët propagandojnë lirinë personale deri në shenjtërim, duke thënë: “Askush nuk lejohet ta cenojë lirinë e individit”, por në anën tjetër askush prej tyre nuk pipëtin për femrën e mbuluar me hixhab të besimit hebraik ose të krishterë dhe askush nuk ngre zërin në mbrojtje të gruas muslimane të dhunuar barbarisht në Bosnje, Kosovë, Burma etj. nga jomuslimanët, apo në Siri e gjetkë nga regjimet diktatoriale.

Në krahun tjetër, këta pseudo-mbrojtës të të drejtave të individit ndërhyjnë pa problem tek liria e grave muslimane, të cilat me pëlqimin e tyre janë veshur me hixhab, duke i akuzuar ato si të prapambetura, teksa dihet mirë fakti: se përparimi nuk ka qenë

⁷⁶ - Andrea Dworkin, *Our Blood: Prophecies and Discourses on Sexual Politics*, pp. 27, 105 (Quoted by, Wendy Shalit, op. cit., p.112).

kurrë peng i veshjes dhe paraqitjes së jashtme të njeriut, por ka qenë produkt i hulumtimeve dhe kërkimeve, tek të cilat njeriu arriti përmes mendjes dhe përdorimit të inteligjencës së tij, ndërsa veshja e hixhabit nuk e pengon aspak gruan të fitojë njohuri dhe të thellohet në lëmin shkencor, apo të kryejë detyrimet dhe punët e saj dinjitoze.

Janë pikërisht këta spekulatorë, që bëjnë thirrje për sjellje perverse, duke ftuar për në post-modernizëm përmes nihilizmit (njeriu si një qenie e komanduar nga instiktet e egra, që janë rrënjësor brenda tij, ose nga ligjet mekanike prezente jashtë tij, që ai nuk mund t'i kapërcejë)⁷⁷ dhe nudizmit (pseudofilozofisë së mbulimi qoftë edhe i zonës më intime të trupit të meshkujve apo femrave në ambientet publike është vetëm një ndrydhje artificiale shoqërore, pasi në origjinë njeriu duhet të mjaftohet me lëkurën e tij dhe të mos ketë nevojë për asnjë rrobë, aq sa po të dalë në mesin e tyre një grua me bikini, ajo akuzohet si ekstremiste)⁷⁸...

Nuk ka dyshim, se sipas këtij këndvështrimi vjen edhe përfytyrimi perëndimor mbi “femrën ideale”, e cila - sipas këtij këndvështrimi - është gruaja që refuzon të jetë bashkëshorte, nënë, madje edhe femër, nën diktatin e demagogjisë nihiliste, se seksi (gjinia) është skicim dhe montazh kulturor imagjinar që duhet zhbërë⁷⁹. Kësisoj, gruaja u shndërrua tërësisht në një lodër seksi në shërbim të tregtarëve perëndimorë të “mishit të bardhë” dhe trupi i saj iu nënshtua 7 x 24 (në çdo ditë të javës dhe orë të ditës) masmedias, duke u kthyer në një makineri në shërbim të tregut të reklamave dhe

⁷⁷ - AbdulUehab El-Mesiri, El-Almanije Tahte El-Mixhhar, f. 56.

⁷⁸ - Frances Merrill, Among the Nudists, Early Naturism, Read Books, 2008.

⁷⁹ - Andrea Dworkin, Woman Hating, p.174 (Quoted by, Wendy Shalit, op. cit., p.197).

zbavitjes... Me kalimin e kohës, gruaja në Perëndim nga “mëkatare e pavullnetshme” u shndërrua në “mëkatare të vullnetshme”, stimuluar nga goja e demagogeve më me zë perëndimore, njëra prej të cilave (Naomi Wolf) tha pa asnjë ngurrim: “Nuk ekzistojnë vajzat e mira (të mbara). Të gjitha ne jemi vajza të këqija (të mbrapshta)”⁸⁰; për të qenë në çdo rast një manekin (kukull), me bukurinë e të cilës dëfrehen meshkujt, për sa kohë që këtij manekini s’i ka rënë boja. Me mbarimin e hijeshisë dhe freskisë së tyre femërore, shterojnë edhe aspiratat e këtyre grave, të cilat nga “gra plot hir” kthehen në “copa mishi me dy sy”, që nuk i honeps kush dhe nuk përbëjnë më kurrfarë vlere!

FAKTI I TRETË: HIXHABI ËSHTË TRADITË E GRAVE TË FISME DHE MBRON PRIVATËSINË E GRUAS

Çështja e hixhabit (rrobës/mbulesës fetare të gruas muslimane) është e njëjtë si tradita e monarkëve, shtresave elitare apo e një shtrese të caktuar të një populli, të cilët vishen me rroba të veçanta, serioze dhe të gjata...

Të gjithë i dëshirojmë makinat me xhama të errët, që simbolizojnë dëshirën e pamanipuluar të njeriut për privatësi. Tek femra muslimane, këtë dëshirë e krijon më së miri hixhabi mbulues i saj. Meshkujt mahrem janë pikërisht ata njerëz, të cilët i përkasin jetës sonë private, “brenda territoreve tona me xhama të zinj/pa hixhab”, ndërsa për të tjerët është krejt normale, që të mbeten jashtë këtyre territoreve...

⁸⁰ - Wendy Shalit, op. cit., p.8.

Më e mira që mund të pyetet për vlerën e hixhabit (mbulesës fetare) është gruaja muslimane. Më konkretisht, në një sondazh të bërë në vitin 2005 nga “The Gallup Organization” nën tematikën “Çfarë duan gratë: Dëgjimi i zërit të muslimaneve”, që përfshiu 8000 gra nga 8 shtete të ndryshme, rezultoi se ato: “nuk e konsiderojnë hixhabin (mbulesën fetare të gruas) padrejtësi, ndryshe nga perëndimorët. Shumica e grave të pyetura mendonin, se gjëja më e keqe e kulturës perëndimore është degradimi (zhvlerësimi) i vlerave humane dhe degjenerimi (shthurja) morale.”⁸¹

Në fakt, realiteti flet qartë, se ai që e fton femrën tek zhveshja, e sheh atë vetëm me syrin, me të cilin kodoshët shohin dashnoret. Kurse ai që e fton femrën tek mbulesa, e bën këtë sepse në mendjen e tij kjo femër shihet me syrin, me të cilin njeriu sheh nënën, motrën dhe bijën e tij, si një segment të pandashëm të tij, si pjesë të shpirtit të tij, me krenari bëhet truproja i saj dhe lëndohet, që ajo të trajtohet si “manekin”, që abuzuesit - pasi dëfrehen - e hedhin në koshin e plehrave...

⁸¹ - Ali Shehata, Heather El Khiyari and Julie S. Mair, *Demystifying Islam: Your Guide to the Most Misunderstood Religion of the 21st Century*, Florida: Elysium River Press, 2007, p.265.

REALITETI I TRETË:

Aspekte të spikatura juridike islame mbi hixhabin

Trajtim i përmbledhur i disa aspekteve të spikatura
juridike islame mbi hixhabin



SË PARI:

Norma të hixhabit

Përkufizimi i hixhabit

Hixhabi sheriatik (rroba/mbulesa fetare e gruas) të cilin gruaja obligohet ta veshë, kur del nga shtëpia e saj (apo në ambientet ku ka burra të huaj, që nuk janë mahrem për të), është çdo veshje që e mbulon tërë trupin e saj, duke përmbushur tre kushtet në vijim:

Kushti i parë: ta mbulojë të gjithë trupin e saj (me përjashtim të fytyrës dhe pëllëmbëve të duarve, sipas disa mendimeve të dijetarëve muslimanë);

Kushti i dytë: të mos jetë zbukurim në vetvete, të mos jetë i hollë dhe i tejdukshëm, të jetë i bollshëm dhe serioz, të mos nxjerrë në pah format e trupit dhe të mos jetë i parfumosur apo i aromatizuar;

Kushti i tretë: të mos u përngjajë rrobave të meshkujve, të jobesimtareve apo femrave të shthurura dhe të mos jetë rrobë që vishet për famë.⁸²

⁸² - Dy kushtet e para janë për rrobën që duhet të veshë gruaja muslimane jashtë shtëpisë, kurse kushti i tretë vlen për veshjen e saj brenda apo jashtë shtëpisë.

Dispozita e hixhabit

Hixhabi (rroba/mbulesa fetare e gruas) është një obligim hyjnor, braktisja tërësore e të cilit përbën një mëkat të madh, që e ekspozon vepruesen e saj para ndëshkimit në zjarrin e Xhehenemit...

Në lidhje me mosveshjen e hixhabit nga grua muslimane në ambientet ku gjenden meshkuj të huaj (që nuk janë mahrem për të), dijetarët muslimanë thonë, se një gjë e tillë përbën sigurisht një mëkat të madh...

Besimtarja e devotshme duhet ta tregojë veten e saj edhe përmes paraqitjes së saj të jashtme. Besimi dhe përkushtimi i saj duhet të shfaqen botërisht në veshjen e saj, ashtu si në fjalët dhe veprat e saj; të ndriçojnë çdo sjellje dhe situatë të saj dhe ta imunizojë atë nga pispillosja dhe zbulimi, që Allahu i Madhëruar i ka cilësuar si veprime të kohës së padijes: “**...mos i zbuloni stolitë** (hijeshitë) **tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes** [në periudhën paraislame]!”⁸³

Po në këtë kontekst, profeti Muhamed (Paqja qoftë mbi të) ka thënë: “*Dy kategori prej banorëve të zjarrit nuk do t’i shoh: një popull që bart kamxhikë si bishtat e lopëve [me të cilët keqtrajtojnë padrejtësisht njerëzit] dhe gra të veshura por të zhveshura, që ecin dhe i mësojnë edhe të tjerat të ecin duke u anuar [me arrogancë dhe mendjemadhësi], kokat e tyre [i modelojnë me copëra dhe ngjashëm që i bëjnë të] duken si gungat e lëkundshme të devesë, ato s’kanë për të hyrë në Xhenet dhe as kanë për ta ndjerë aromën e tij, teksa faktikisht aroma e tij ndjehet në një distancë prej kaq e kaq [në një transmetim vjen ‘nga 40 vjet larg’⁸⁴].*”⁸⁵

⁸³ - Kuran, El-Ahzab: 33.

⁸⁴ - El-Bukhari 6914.

⁸⁵ - Sahihu Muslim 2128.

Në tekstet e shenjta të mësipërme spikatet qartë pispillosja e ndaluar dhe fakti se mungesa e veshjes korrekte, nga e cila lëngonjë shumë femra, gjen shprehi përmes:

- 1- veshjes së njërës pjese të trupit dhe zbulimit të tjetrës,
- 2- veshjes me rroba të ngushta, që nxjerrin në pah format e trupit dhe
- 3- veshjes me rroba transparente poshtë të cilave duket trupi.

Gjithashtu në këtë hadith profetik shprehet qartë kërcënimi i rreptë, që i mjafton çdo gruaje që beson Allahun dhe botën tjetër (Ahiretin), për t'u frenuar nga pispillosja, zbulimi dhe ekspozimi i hijeshive femërore para atyre meshkujve, që ajo nuk i ka mahrem, të cilët nuk lejohet t'i shikojnë ato...

Para kujt vishet hixhabi dhe para kujt nuk vishet

Përsa i përket veshjes së gruas muslimane para burrave të huaj, që nuk janë mahrem për të, dijetarët muslimanë thonë, se ajo veshje duhet të mbulojë gjithë trupin e saj, përveç fytyrës, dy pëllëmbëve të duarve dhe (sipas disa mendimeve) këmbëve nga kyçet/nyjat e poshtë.

Ndërsa sa i përket kategorisë së burrave që janë mahrem (me të cilët një femre muslimane i ndalohet përjetësisht martesë), muslimanes së rritur i lejohet që para tyre të zbulojë prej pjesëve të trupit të saj më shumë se fytyrën dhe pëllëmbët e duarve, pra mund të zbulojë: flokët, fytyrën, krahët, këmbët poshtë gjunjëve, etj.

Konkretisht kategoria *mahrem* është cituar në ajetin kuranor në vijim:

“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre [nga e ndaluara], **ta ruajnë nderin e tyre** [nga marrëdhëniet jashtë kurore] **dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre** [stolitë dhe pjesët e trupit ku vendosen stolitë],

përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i mbulojnë kraharorët me mbulesat e tyre [të kokës] dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveç:

- **bashkëshortëve të tyre** [mbulesa në rend të parë është në interes të bashkëshortit],
- **ose baballarëve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe gjyshërit e besimtares nga babai dhe mamaja, e sipër],
- **ose vjehërrve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe babai i vjehrrit dhe vjehrrës së besimtares, e sipër],
- **ose bijve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe djemtë e bijve dhe bijave të besimtares, e poshtë],
- **ose djemve të bashkëshortëve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe djemtë e bijve dhe bijave të bashkëshortit të besimtares, e poshtë],
- **ose vëllezërve** [të besimtares],
- **apo djemve të vëllezërve të tyre** [ku bëjnë pjesë edhe djemtë e bijve dhe bijave të vëllezërve të besimtares, e poshtë],
- **ose djemve të motrave** [ku bëjnë pjesë edhe djemtë e bijve dhe bijave të motrave të besimtares, e poshtë],
- **a grave të tyre** [muslimaneve të tjera ndër to],
- **ose atyre që i kanë nën zotërim** [skllaveve],
- **ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave,**
- **apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave.**⁸⁶

Përveç personave të përmendur në ajetin e mësipërm kuranor, dijetarët kanë përmendur se tek *mahremi* bëjnë pjesë edhe: dajallarët dhe xhaxhallarët (e besimtares), si dhe afërsia për shkak të pirjes gjë

⁸⁶ - Kuran, En-Nur: 31.

tek një mëndeshë⁸⁷.

Me fjalë të tjera, për termin islam “mahrem” është thënë:

Kategoria *mahrem* i referohet grupit të burrave, me të cilët një grua nuk mund të martohet kurrë në jetë, për çdonjërin prej tre shkaqeve në vijim:

Shkak i parë: *mahrem* për shkak të lidhjeve të gjakut si: babai, biri, vëllai, xhaxhai, daja, djali i vëllait dhe djali i motrës (nipat) etj.;

Shkak i dytë: *mahrem* për shkak të pirjes gji (qumësht) tek një mëndeshë, ku përfshihen: burri i mëndeshës (që konsiderohet baba i foshnjës nga gjiri), biri i mëndeshës (që konsiderohet vëlla i foshnjës nga gjiri), vëllai i mëndeshës (që konsiderohet dajë i foshnjës nga gjiri) dhe kështu me radhë sikurse u përmend në shkakun e parë;

Shkak i tretë: *mahrem* për shkak të martesës (krushqisë): janë: babai i burrit (vjeherri), djali i burrit (thjeshtri), burri i mamasë (njerku) dhe burri i vajzës (dhëndri).

Gjithsesi duket qartë hierarkia që përdor Kurani në çështjen e lejimit të zbulimit të më shumë se fytyrës dhe duarve të femrës, para personave të kategorive në fjalë, gjë që nënkupton se ky zbulim nuk është njëlloj për të gjithë, por vjen nga zgjerimi drejt ngushtimit, pra lejohet zbulimi para burrit, pastaj një zbulim më i limituar lejohet para babait, e kështu me radhë.

⁸⁷ - Mëndeshë: Gruaja që i jep gji një foshnje të huaj derisa të rritet, me kusht që: foshnja të ketë pirë gji të paktën pesë herë të sigurt (ku në secilën pirje foshnja të jetë ngopur apo të ketë pirë deri sa të ketë lëshuar gjirin vetë) dhe të ketë pirë gji kur ka qenë dy vjeç e poshtë. Lidhjet e qumështit kanë të njëjtin efekt ndalimi siç kanë lidhjet e gjakut, pra për shkak të pirjes së qumështit bëhen të ndaluar për martesë: babai, biri, vëllai, xhaxhai, daja, djali i vëllait dhe ai i motrës (dhe kështu me radhë sikurse tek lidhjet e gjakut); nga qumështi.

Jashtë kësaj kategorie, gruas i lejohet të zbulojë vetëm fytyrën, dy pëllëmbët e duarve dhe (sipas disa mendimeve) këmbët nga kyçet/nyjat e poshtë...

Mosveshja e hixhabit është një prej mëkateve të mëdha

Siç u cek më sipër, dijetarët muslimanë thonë, në lidhje me mosveshjen e hixhabit nga gruaja muslimane në ambientet ku gjenden burra të huaj (që nuk janë mahrem për të), se një gjë e tillë përbën pa dyshim një mëkat të madh, pra dispozita që jepet për një rast të tillë është e njëjtë me dispozitën që jepet ndaj atyre që kryejnë mëkate të mëdha...

Dispozita për atë që kryen mëkate të mëdha

Sa i përket aspektit akaidologjik⁸⁸ islam, nëse besimtari që falet kryen edhe disa mëkate, ai përsëri mbetet në Islam (pra konsiderohet musliman) përderisa:

- a) nuk bën ndonjë veprim që e nxjerr nga Islami;
- b) nuk shfuqizon dispozitat kategorike të Islamit, si p.sh: rasti kur personi hallallin⁸⁹ kategorik e bën haram⁹⁰ ose anasjellas, me kusht që këto dispozita (lejime apo ndalime) kategorike:

⁸⁸ - Akaidologjik: Epitet i termit “akide”; kjo e fundit përbën një subjekt të shkencave islame, që merret me çështjet e kredos (bindjes) islame.

⁸⁹ - Hallalli: Me këtë term islam nënkuptohet çdo gjë që është në përputhje me ligjin islam, apo ligjshmëria e diçkaje sipas kodit islam. Më konkretisht këtu hyjnë lejitimet hyjnore islame.

⁹⁰ - Harami: Me këtë term islam nënkuptohet çdo gjë që është në kundërshtim me ligjin islam apo paligjshmëria e diçkaje sipas kodit islam. Më konkretisht këtu hyjnë ndalimet (ndalesat e obliguara) hyjnore islame.

1- të jenë dekretuar si të tilla me konsensus (mendim unanim) të dijetarëve muslimanë;

2- dispozita e tyre të jetë qartësuar për besimtarët pa pikë dyshimi dhe pa lënë vend për asnjë lloj interpretimi ndryshe.

Një musliman që kryen ato gjëra, që u cekën më lart, quhet mëkatar dhe në amshim meriton të ndëshkohet në zjarrin e Xhehenemit, por çështja e tij mbetet në dorë të Allahut të Madhëruar: nëse Ai do e ndëshkon dhe nëse do e fal. Pra asnjë njeri nuk mund të thotë në mënyrë kategorike, se një person i tillë do të ndëshkohet ose jo, sepse kjo çështje i takon vetëm Allahut të Madhëruar dhe vetëm Ai ka dijeni për të. Ajo që dihet fetarisht është, se edhe nëse personi në fjalë hyn në zjarrin e Xhehenemit në botën tjetër, ai nuk do të mbetet përjetësisht në të...

Për ta kuptuar sa më mirë atë që u përmend më lart, do të ishte e udhës të shpjegonim në mënyrë të përmbledhur në rreshtat në vijim konceptin e mëkateve të mëdha dhe mëkateve të vogla.

Mëkatet e mëdha dhe mëkatet e vogla

Mëkate të mëdha quhen:

a) të gjitha mëkatet, që ligji islam i ka konsideruar vepra penale dhe në këtë botë ka vendosur masa të caktuara ndëshkimore për mëkate të tilla, si: vrasja, prostitucioni, vjedhja, etj.;

b) të gjitha mëkatet për të cilat ka ardhur kërcënim hyjnor specifik (i veçantë), ku bëjnë pjesë:

1- të gjitha mëkatet që Shpallja Hyjnore ka përmendur, se do të ndëshkohen ashpër në botën tjetër;

2- të gjitha mëkatet që Shpallja Hyjnore ka përmendur, se vepruesin e tij e kaplon mallkimi a zemërimi i Zotit.

Mëkatet e mëdha janë të shumta dhe ndër to spikatin: keqtrajtimi i prindërve, gënjeshtria, dëshmia e rrejshme, magjia, prostitucioni (kurvëria), vrasja pa të drejtë, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit (pa të drejtë), thashethemet dhe shpifja, dezertimi nga fronti i betejës, shpifja kundër grave të ndershme, vjedhja, braktisja e hixhabit nga femrat, etj.

Mëkate të vogla quhen të gjitha mëkatet e tjera, që nuk arrijnë gradën e mëkateve të mëdha. Mëkatet e vogla:

- a) nuk dënohen me masa konkrete ndëshkimore në dynja;
- b) nuk janë kërcënuar me ndëshkim hyjnor të veçantë;
- c) nuk sjellin dëm të madh.

Këto mëkate konsiderohen të vogla, me kusht që personi të mos ngulmojë në to, duke i kryer ato vazhdimisht. Të tilla janë mëkatet si: shikimi i haramit, qëndrimi në shoqërinë e njerëzve të shthurur, grindjet e shumta, heshtja kur dikush bën thashetheme, nxjerrja e sekreteve, moskorrektesa në takime, lajkatimi (për interesa dynjaje), etj.

Shlyerja e mëkateve të mëdha dhe të vogla

a) Mëkatet e mëdha shlyhen (falen) përmes pendimit (teubes) para grahmës së vdekjes. Ky pendim duhet të jetë i sinqertë vetëm për hir të Allahut dhe duhet të përmbushë kushtet në vijim:

1- të pranosh mëkatin dhe të shprehësh keqardhje (pendim) për kryerjen e tij;

2- të largohesh (të heqësh dorë) menjëherë prej tij;

3- të vendosësh që të mos e kryesh kurrë më atë mëkat;

4- në rastin kur mëkati i madh është bërë në dëm të një njeriu tjetër, duhet t'ia kthesh hakun (të drejtën) tjetrit, apo t'i marrësh hallallëkun atij.

b) Mëkatet e vogla shlyhen dhe falen gjithashtu me pendimin e lartpërmendur (teube), por krahas kësaj ato falen edhe nëpërmjet: faljes së namazeve farze dhe namazit të Xhumasë, agjërimit të Ramazanit, kryerjes së Haxhit, kryerjes së veprave të mira me përpikmëri dhe në mënyrë sistematike, etj.

- Bazuar në atë që u përmend, nuk mund të thuhet në mënyrë kategorike, se muslimanja që e ka lënë hixhabin dhe nuk është angazhuar me të, do të futet patjetër në zjarr, por duhet ditur se ajo e meriton ndëshkimin e Allahut të Madhëruar, pasi ka lënë pas dore urdhrin obligativ madhor të veshjes së hixhabit, me të cilin Allahu e ka urdhëruar.

Sidoqoftë, përfundimin e saj në botën tjetër e di vetëm Allahu i Madhëruar, kurse neve nuk na takon të flasim për ato gjëra, për të cilat nuk kemi dijeni, duke zbatuar kështu fjalët e Allahut të Madhëruar: **“Mos shko pas diçkaje, për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.”**⁹¹

⁹¹ - Kuran, El-Isra: 36.

SË DYTË:

Thyerja e barrierave të veshjes së hixhabit

Çfarë nuk bëhet plotësisht, duhet të bëhet përafërsisht

Sigurisht që femra muslimane e di mirë, se krahas veshjes së trupit të saj, gjendet edhe një “veshje” tjetër, që Allahu i Madhëruar e ka quajtur “devotshmëria para Allahut” dhe nëse kjo devotshmëri do ta “veshë hijshëm” zemrën e gruas muslimane, atëherë me lejen e Allahut, muslimanja do t’i përballojë edhe sfidat e veshjes së hixhabit, duke zbatuar kështu me dëshirë urdhrin e Allahut të Madhëruar dhe duke qenë e bindur, se në këtë urdhër gjendet mirësia e saj në të dy botët...

Femra muslimane e provuar me mosveshjen e hixhabit duhet ta pranojë pa mëdyshje faktin, se ajo ka lënë pa kryer një obligim madhështor prej urdhrave hyjnorë dhe duhet t’i lutet Allahut të Madhëruar, që t’ia mundësojë sa më shpejt të veshë hixhabin me vullnetin e saj, para se të vijë momenti kur ajo do të vishet me qefin pa vullnetin e saj, moment që mund ta befasojë njeriun në çdo kohë...

Sidoqoftë, edhe nëse muslimanja gabon dhe nuk e vesh hixhabin, ndikuar nga presioni i frymës jofetare që e rrethon, ajo duhet që në

rrugën e zbatimit të obligimit për veshjen e hixhabit, t'i përmbahet me rigorozitet veshjes serioze dhe modeste, që shfaq dukshëm dinjitetin, modestinë dhe identitetin e saj fetar, si p.sh. të mbajë një shall për fyti; t'i mbledhë dhe mbulojë flokët, ose së paku shumicën e tyre me kapuç, shall a shirit; të vishet me rroba të gjera, modeste, me rroba jo të tejdukshme, që i shkojnë deri në fund të këmbëve etj., sipas parimit “çfarë nuk bëhet plotësisht, duhet të bëhet përafërsisht”.

Gjithashtu, muslimanja duhet të përpiqet pareshtur, që të mos asimilohet në shoqërinë jofetare ku jeton e të humbasë gjënë më të shtrenjtë që ka - identitetin e saj islam -, rruga e humbjes së të cilit fillon zakonisht duke u dobësuar para presioneve të shoqërisë jofetare dhe duke bërë lëshime në disa parime dhe bindje islame, për t'u zgjeruar më tej plasaritja në pasoja të palavdërueshme dhe tepër të vështira për t'u riparuar...

Strategjia e kapërcimit të barrierës së mosveshjes së hixhabit nga turpi prej opinionit

I këshillojmë motrat tona muslimane, që për të dalë të suksesshme në testin e rëndësishëm të veshjes së hixhabit, të zbatojnë strategjinë e shmangies së problemit të turpit prej opinionit. Kjo strategji zbatohet, duke ndjekur hapat efikasë në vijim, që afrojnë shumë tek hapi final i veshjes së hixhabit (mbulesës fetare të gruas muslimane):

Hapi i parë: ta blejë hixhabin, duke pasur qëllim në zemër, se do ta veshë së shpejti, të falet me të në namazet ditore, ta veshë atë kur të jetë vetëm dhe ta shikojë veten me të në pasqyrë sa më shpesh, duke e menduar veten se po ec me të në rrugë dhe duke menduar gjithashtu kënaqësinë e Zotit të saj me të. Po kështu, ta veshë hixhabin sa herë që ndodhet në ambiente të mbyllura me motra muslimane, ose me persona që e përkrahin në këtë nismë të saj...

Hapi i dytë: të vishet me një rrobë serioze, që e mbërthen trupin e saj bollshëm nga këmbët e deri lart tek fyti, si për shembull: kostum fund-xhakete ose fund-bluzë (ose ngjashëm), që duhet të plotësojnë kriteret islame...

Hapi i tretë: për zonën e mbetur të kokës, si fillim të vendosë gjatë gjithë dimrit dhe vjeshtës një kapuç; ndërsa verës ndonjë kapele apo ngjashëm...

Hapi i katërt: pasi të kalojë disa muaj në këtë gjendje, të shkojë për pushime apo vizitë në një vend ku nuk e njohin, apo ku e përkrahin në nismën e saj të veshjes së hixhabit, duke qëndruar gjatë gjithë kohës - nga momenti që del nga shtëpia e derisa të kthehet - e veshur me veshjen e kompletuar islame (pra me hixhab). Në kthim, t'i lutet pandërprerë Allahut të Madhëruar, që t'i japë qëndresë në zbatimin me sukses të këtij urdhri solemn hyjnor.

Ndoshta këto do të jenë hapat e duhur dhe motra muslimane ka për ta parë, se me lejen e Allahut shumë shpejt do të jetë si shumë motra të tjera përreth saj, të cilat falë besimit të tyre jo vetëm që nuk e kanë problem dhe shqetësim veshjen e hixhabit, por përkundrazi e kanë atë burim krenarie...

SË TRETË:

Dy pyetje të shpeshta në lidhje me hixhabin**Qëndrimi i bashkëshortit musliman ndaj bashkëshortes që nuk e vesh hixhabin**

Dijetarët muslimanë theksojnë, se nuk është gjynah për burrin musliman, që të bëjë durim me gruan e tij, e cila nuk e ka vendosur akoma hixhabin (mbulesën fetare të gruas) dhe të mos mendojë për t'u divorcuar prej saj, përderisa ai sheh, se ka hapësirë për përpjekje të reja drejt bindjes së gruas së tij për ta veshur hixhabin (mbulesën).

Duhet ditur gjithashtu, se edhe motra e nderuar që përpiqet dhe i djeg në zemër fakti, se po qëndron pa hixhab (veshjen/mbulesën fetare të gruas), me siguri që nuk është e ngarkuar njësoj me gjynah, si motra muslimane që është adoptuar me jetën pa hixhab dhe as që e ka në rend të ditës çështjen e veshjes së hixhabit...

Vlefshmëria e namazit të asaj që nuk e vesh hixhabin

Dijetarët tanë të afirmuar theksojnë faktin e sigurt, se gruaja që në jetën publike nuk e vesh hixhabin, me siguri që ka rënë në një mëkat të madh. Gjithsesi ata thonë, se ky nuk është prej kushteve të namazit apo agjërimit, prandaj nëse kjo grua muslimane që falet dhe

agjëron, ka bindjen se hixhabi (veshja fetare e gruas) është obligim hyjnor, atëherë namazi dhe agjërimi i saj është i saktë (i vlefshëm), edhe nëse ajo ende s'e ka veshur hixhabin në jetën publike...

Pra nëse ajo e kryen namazin dhe agjërimin e saj, duke plotësuar me rigorozitet kushtet dhe obligimet përkatëse të këtyre adhurimeve, namazi dhe agjërimi i saj konsiderohen të rregullta. Për më tepër shpresohet që namazi dhe agjërimi i saj i përkushtuar, të bëhen shkak që ajo të zbatojë edhe obligimin hyjnor të veshjes së hixhabet (mbulesës fetare të gruas)...

Sidoqoftë, femra muslimane që ende nuk e ka veshur hixhabin, duhet ta konsiderojë këtë gjendje të saj si tregues të dobësisë dhe mangësisë në besim, prandaj ajo duhet të nxitojë sa më shpejt që ta veshë hixhabin...

Allahu e di më mirë.

Çdo lavdërim dhe falënderim i përket Allahut, Zotit të botëve.

Referencat:

Shënim: Si referencë qëndrore ka shërbyer libri “El-Hixhab SheriatuLlahi fil Islam, uel Jehudije uen Nasraniye/Hixhabi është ligji i Allahut në Islam, Hebraizëm dhe Krishterim”, me autor Sami Amiri, si dhe materialet e portaleve islame: “islamweb.net”, “islamqa.info”, “islamway.net”, “saaid.net”, “shamela.ws” etj.

Referenca fetare islame:

Kurani i Madhërishëm dhe kuptimet e tij në gjuhën shqipe,
Prof. Hasan I. Nahi, botimi i AIITC-së

El-Bukhari, Sahihul Bukhari

Muslim, Sahihu Muslim

Ahmed, Mesnedu Imami Ahmed

Ed-Dijau El-Makdesi, El-Ehadith El-Mukhtara

Ebu Daud, Sunenu Ebi Daud

Ed-Darimi, Sunenu Ed-Darimi

Edh-Dhehebi, El-Mijzan

El-Bejhaki, Es-Sunen El-Kubra

El-Hakim, El-Mustedrak Ale Es-Sahihejni
El-Xheziri, El-Fikhu ale El-Medhahib El-Erbea
En-Nesai, Sunenu En-Nesai
Et-Tabarani, El-Muaxhemu El-Kebir
Et-Tirmidhi, Sunenu Et-Tirmidhi
Ibn Haxher, Et-Telkhis
Ibn Haxher, Fet’hu El-Bari
Ibn Hazëm, Maratibu El-Ixhma
Ibn Maxhe, Sunenu Ibn Maxhe,
Albani, Sahihu El-Xhamia
Muhamed Shemsulhak El-Adhimabadi, Aunu El-Meabudi
Ali Shehata, Heather El Khiyari
AbdulUehab El-Mesiri, El-Almanije Tahte El-Mixhhar
Ragib Es-Sirxhani, Er-Rahmetu fi Hajati Er-Resul
Sami Amiri, El-Hixhab Sheriatullahi fi El-Islam, ue El-Jehudije
ue En-Nasranije

Referenca të tjera:

A. Rousselle, ‘Body Politics in Ancient Rome’
Alvin J. Schmidt, Veiled and Silenced
Andrea Dworkin, Our Blood
Catechism of the Catholic Church
Charles Bigg, The Origins of Christianity

Charles Hodge, Commentary on the First Epistle to the Corinthians

Clara M. Henning, Cannon Law and the Battle of the Sexes

Dio Chrysostom, Discourse

Donald B. Kraybill, The riddle of the Amish Culture

Dr. Leila Leah Bronner, From veil to wig: Jewish women's hair covering

Encyclopædia Britannica. 2008.

Frederiko Mayer, New World.

G. Ellinson, Women and Mitzvot: The Modest Way

Hippolytus, On the Apostolic Tradition

John Duncan Martin Derrett, Studies in the New Testament

Joyce E. Salisbury, Church Fathers, Independent Virgins

Menachae M. Brayer, The Jewish Woman in Rabbinic Literature

R. Menahem b. Benjamin Recanati, Sefer Recanati

Saint Alphonso Liguori, True Spouse of Jesus Christ

Tertullian, 'the Instructor,' in The Ante-Nicene Fathers

The Ante-Nicene Fathers

The Homilies of St. John Chrysostom, Archbishop of Constantinople

The Oxford Dictionary of the Jewish Religion

Portalet:

<http://islamway.net>

<http://islamweb.net>

<http://islamqa.info>

<http://nabulsi.com>

<http://saaaid.net>

<http://shamela.ws>

<http://soundvision.com>

<http://yvonneridley.org>

<http://library.eb.com>

<http://dol.gov>

Prezantim i shkurtër me autorin:

Altin Torba lindi me 09.07.1975 në Bulqizë dhe po aty përfundoi Shkollën e Mesme të Përgjithshme (1989-1993). Më pas, kreu 2 vjet studime në Institutin Teologjik Islam “Ebu Hanife” (1994-1996) po në Bulqizë. U diplomua në Universitetin “El-Iman”, profili “Teologji Islame”, në Sana të Jemenit (1997-2001) dhe pak vite më vonë u diplomua në Fakultetin e Shkencave Sociale, profili “Edukatë Qytetare”, në Universitetin ‘Aleksandër Xhuvani’, në Elbasan (2004-2009).

Njeh në nivelin “shumë mirë” arabishten; ka punuar kryesisht në fushën e thirrjes islame si mësues i teologjisë dhe ligjërues xhamie në Shqipëri dhe jashtë saj.

Gjithashtu, ka një qasje të ngushtë me literaturën islame në lëmin e përpilimit, sidomos në atë të përkthimit. Në këtë kuadër, është autor i një sërë përpilimesh të përkthyer, por edhe autoriale, të botuara në një sërë revistash si: “Drita Islame”, “Familja”, “Etika”, “Vepra” etj.


Sa i përket lëmit të përkthimit, është autor i një vargu përkthimesh për një kohë relativisht të gjatë, fillimisht për faqen elektronike “Ikra” dhe më pas për portalet elektronike “Ardhmëriaonline” dhe “ProfetiMuhamed.info”.

Nga viti 2018 është anëtar i stafit të përkthyesve shqiptarë të portalit të njohur “IslamHouse.com”. Ndërsa në fushën e botimit të librit islam është angazhuar si përkthyes për një sërë librash të botuar nga disa shtëpi botuese, si: “Mesazhi”, “Furkan ISM”, etj.

Në periudhën 2011-2013 ka pasur një angazhim radiofonik në Radio Kontakt, ku ka drejtuar emisione të formatit fetar dhe social.

Po kështu, është përgjegjës i faqes “Jeta e Vërtetë - Pyetje-Përgjigje Fetare Islame (facebook)” dhe portalit teologjik islam “www.jetaever8.de (Jeta e Vërtetë)”.

Nga viti 2011-të shërben në faltoren “Ikra” si imam për muslimanët shqiptarë të qytetit Siegen në Gjermani dhe prej vitit 2015 është anëtar i Komisionit të Fetvave pranë Unionit të Bashkësive Islame Shqiptare në Gjermani (UBISHGJ).



*Allahu i shpërbleftë të gjithë ata që
i luten Zotit për mbarësi e lumturi
të përdybotshme për autorin e këtij
libri, për atë që mundësoi botimin
e tij, për grupin e punës dhe
për mbarë muslimanët.*



ALTIN TORBA

DOMOSDOSHMERIA E HIXHABIT NE DRITEN E ARGUMENTEVE HYJNORE DHE LOGJIKE

Hixhabi (mbulesa fetare e gruas) është ligj hyjnor në Islam, Hebraizëm dhe Krishterim

- **REALITETI I PARË:**

Hixhabi në qytetërimet e hershme dhe ligjet hyjnore
Domosdoshmëria e hixhabit në qytetërimet e hershme
Zhveshja e femrës, risi e rendit të dekadave të fundit
Domosdoshmëria e hixhabit në Hebraizëm, Krishterim dhe Islam
Profeti (Paqja qoftë mbi të) model në sjelljen me femrat

- **REALITETI I DYTË:**

Domosdoshmëria e hixhabit në logjikën e shëndoshë
Domosdoshmëria e hixhabit në natyrën fiziologjike humane
Islami e njëj tërheqjen fiziologjike mes dy gjinive të kundërta njerëzore
Epshi njerëzor është asnjans dhe moskontrollimi i tij sjell rrënimin
Domosdoshmëria e hixhabit në mirëqenien sociale
Zhveshja shpie në shpërbërje të familjes, anarki dhe shtazëri
Hixhabi konsolidon etikën e lartë dhe modestinë
Mirazhi i mirëqenies femërore në botën që injoron hixhabin
Domosdoshmëria e hixhabit në logjikën e shëndoshë
Zhveshja nga hixhabi përbën zhvlerësim, ndërsa veshja e tij fisnikëri
Spekulimet me hixhabin janë joparimore dhe për interesa të ngushta

- **REALITETI I TRETË:**

Aspekte të spikatura juridike islame mbi hixhabin
Dispozita të hixhabit
Kapërcimi i barrierës së mosveshjes së hixhabit nga turpi
Dy pyetje të shpeshta në lidhje me hixhabin